

ANALIZË

LIRIA E SHPREHJES DHE SIGURIA E GAZETARËVE PARA GJYKATËS NË STRASBURG



ANALIZË E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË RASTET E
MAQEDONISË SIPAS NENIT 10 TË KONVENTËS
EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Titulli

Analizë: Liria e shprehjes dhe siguria e gazetarëve para Gjykatës në Strasburg – Analizë e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e Maqedonisë sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Projekt

[„safejournalists.net“](http://safejournalists.net)

Botues

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Autorë

Mr. Velimir Delovski dhe Dr. Kostadin Bogdanov

Recensent

Prof. dr. Besa Arifi

Redaktor

Dragan Sekulovski

Përkthyes nga gjuha maqedonase

Kristina Naceva



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë



Kjo analizë është kryer me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe autorëve dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

RECENSION I ANALIZËS:

LIRIA E SHPREHJES DHE SIGURIA E GAZETARËVE PARA GJYKATËS NË STRASBURG – ANALIZË E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË RASTET E MAQEDONISË SIPAS NENIT 10 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	4
---	---

1. HYRJE	11
----------	----

1.1. Fushëveprimi dhe zbatimi i nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	11
--	----

1.2. Rastet e Maqedonisë para GJEDNJ lidhur me lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve	17
---	----

2. REZYME E RASTEVE TË MAQEDONISË PARA GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME LIRINË E SHPREHJES DHE SIGURINË E GAZETARËVE	20
---	----

2.1. <i>Selmani dhe të tjerët</i>	20
-----------------------------------	----

2.2. <i>Makraduli</i>	28
-----------------------	----

2.3. <i>Gelevski</i>	35
----------------------	----

2.4. <i>Kostova dhe Apostolov</i>	39
-----------------------------------	----

3. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	45
--------------------------------	----

RECENSION I ANALIZËS:

LIRIA E SHPREHJES DHE SIGURIA E GAZETARËVE PARA GJYKATËS NË STRASBURG

- ANALIZË E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË RASTET E MAQEDONISË SIPAS NENIT 10 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Prof. dr. Besa Arifi

Liria e shprehjes është një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: RMV), si dhe me një sërë instrumentesh ndërkombëtare, ndër të cilat Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore është veçanërisht e rëndësishme (në tekstin e mëtejme: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa, KEDNJ). Liria e shprehjes dhe mediat e lira janë gurë-themeli i një shoqërie demokratike. Gazetarët, por edhe personat e tjerë (shkrimtarë, kolumnistë, artistë, blogerë, si dhe të gjithë qytetarët) që nxisin debatin publik në lidhje me proceset shoqërore të një vendi konsiderohen si roje të demokracisë, baza e së cilës është jo vetëm pluralizmi politik, por edhe pluralizmi i ideve dhe i pikëpamjeve të ndryshme. Një debati i tillë i lirë, publik dhe thelbësor për procese të rëndësishme ka një rëndësi të madhe për sigurimin jo vetëm të pluralizmit politik formal gjatë zgjedhjeve, por edhe të qeverisjes transparente, si dhe të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve të një shteti.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ ose Gjykata) është e pasur me raste përmes të cilave kjo gjykatë i përcakton elementet e lirisë së shprehjes, si dhe mënyrën se si zbatohet neni 10 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja në katër aktgjykime ka trajtuar rastet e ankuesve nga RMV-ja për shkelje të lirisë së shprehjes. Në analizën e aktgjykimeve të GJEDNJ-së në rastet e Maqedonisë sipas nenit 10 të GJEDNJ-së, autorët u referohen pikërisht atyre katër rasteve para GJEDNJ-së, në të cilat Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 10.

Analiza përbëhet nga hyrja, analiza të veçanta të dhëna për të katër rastet para GJEDNJ-së dhe pjesa përmblyëse, në të cilën numërohen edhe rekomandimet specifike të autorëve. Analiza e secilit prej katër rasteve përfshin: një pasqyrë të fakteve të rastit, gjetjet e GJEDNJ-së - ku analizohet e drejta dhe Gjykata bën një vlerësim nëse neni 10 i GJEDNJ është shkelur, koment i dhënë nga autorët lidhur me aktgjykimin dhe mënyrën e ekzekutimit të aktgjykimit. Në rreth dyzet faqe, autorët bëjnë një analizë të përgjithshme të lirisë së shprehjes të përcaktuar në nenin 10 të KEDNJ-së dhe mënyrës se si praktika gjyqësore e GJEDNJ-së është reflektuar në lidhje me rastet e Maqedonisë pranë kësaj Gjykate. Kjo analizë është veçanërisht e rëndësishme për punën e atyre personave me përvojë të madhe praktike juridike në RMV, për gjyqtarët, prokurorët publikë, avokatët, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, gazetarët, punonjësit akademikë dhe studentët, të cilët mund të mësojnë shumë për mënyrën se si zbatohet neni 10 i KEDNJ-së. Analiza është e shkruar në një gjuhë shumë të qartë, precize dhe të kuptueshme, ndaj do të jetë e dobishme si për publikun profesional, ashtu edhe për publikun e gjerë, duke pasur parasysh se e drejta e shprehjes së lirë është një e drejtë themelore e çdo personi dhe qytetari.

Në pjesën hyrëse të analizës, autorët i referohen përkufizimit të lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të KEDNJ-së dhe i renditin elementet e këtij përkufizimi. KEDNJ-ja në nenin 10 e garanton lirinë e shprehjes si një e drejtë që e gëzon çdo person. Në këtë nen thuhet se kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe transmetuar informacione ose ide, pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht kufijve. Autorët, në mënyrë shumë të qartë, e shpjegojnë kuptimin e kësaj të drejte, si nga këndvështrimi historik, ashtu edhe për rrethanat e tanishme, si një e drejtë themelore e njeriut në një shtet demokratik. Autorët theksojnë se përcaktimi i lirisë së shprehjes pas dy luftërave botërore dhe Holokaustit, si një e drejtë themelore e njeriut, kishte një rëndësi të madhe për proceset politike dhe demokracinë, e cila bazohet në themelet e debatit publik ndërmjet oponentëve politikë, pluralizmit, të drejtat e pakicave, si dhe në funksionimin e përgjithshëm të shoqërisë civile në tërësi.

Liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute dhe ka baza për ta kufizuar atë. Këto baza janë dhënë në paragrafin e dytë të nenit 10 të KEDNJ-së, ku theksohet se kjo e drejtë përfshin detyrime dhe përgjegjësi dhe nën disa kushte të caktuara të parashikuara me ligj mund të kufizohet kur është e domosdoshme në një shoqëri demokratike për "masa të domosdoshme për sigurinë shtetërore, integritetin territorial dhe sigurinë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor. Edhe pse Konventa parashikon një listë mjaft të gjatë të rrethanave për shkak të të cilave kjo e drejtë mund të kufizohet, këto baza duhet të interpretohen në mënyrë restriktive në mënyrë që kjo e drejtë të kufizohet sa më pak dhe më rrallë dhe vetëm kur është absolutisht e domosdoshme në një shtet demokratik.

Autorët e analizojnë në mënyrë koncize sistemin e vlerësimit kur ka rrethana që e kufizojnë lirinë e shprehjes. Autorët fillimisht e analizojnë të ashtuquajturin "efekt ftohës" ose "efekt frenues" (*chilling effect*) në lidhje me ushtrimin e të drejtës për shprehje të lirë. Gjykata vlerëson rast pas rasti nëse, duke zbatuar një masë të caktuar, shteti ka shkaktuar një efekt të tillë parandalues (frenues) që duhet të dëshmohet në një

situatë specifike. Nëse vërtetohet se ka pasur një efekt të tillë, Gjykata fillon vlerësimin e tre standardeve në lidhje me kufizimin e lirisë së shprehjes, duke kërkuar përgjigje për tri pyetje thelbësore:

- 1. nëse masa e kontestuar është e paraparë me ligj/dispozitë,**
- 2. nëse është synuar drejt arritjes së një qëllimi legjitim dhe**
- 3. nëse është e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Autorët i analizojnë në mënyrë të detajuar këto tre standarde nga pikëpamja teorike dhe nga pikëpamja e praktikës gjyqësore së GJEDNJ-së, duke shpjeguar rëndësinë e veçantë të standardit të tretë dhe duke vënë në dukje se është pikërisht përgjigja e pyetjes “Nëse masa e kufizimit të lirisë së domosdoshme në një shoqëri demokratike?” është çelësi për të përcaktuar nëse ka shkelje të së drejtës për shprehje të lirë.**

Autoritet e trajtojnë edhe qëndrimin të GJEDNJ-së lidhur me censurën nga aspekti kur ai vjen në formën e shqiptimit të ndonjë dënimi të caktuar jo-proporcional ose sanksionit. Gjatë analizimit të proporcionalitetit dhe çështjes nëse një masë e caktuar është e domosdoshme në shoqërinë demokratike, autorët, me të drejtë, e theksojnë qëndrimin e GJEDNJ-së se duhet të mos ketë masa/mjete më të buta, të cilat nga njëra anë do të arrinin qëllimin e njëjtë, kurse nga ana tjetër kufizimi i lirisë së shprehjes do të ishte më i vogël. GJEDNJ -ja e interpreton të drejtën e shprehjes së lirë në formë ekstensive duke kërkuar interpretim restriktiv të bazave për kufizimin e kësaj të drejte. Kjo kërkesë, për një interpretim ekstensiv të lirisë së shprehjes, pasqyrohet edhe në vendimet e GJEDNJ-së, kur duhej të vlerësohej ekuilibri ndërmjet kësaj të drejte dhe të drejtës së privatësisë, veçanërisht për personat që janë bartës të funksioneve publike, ku Gjykata kërkon që ata të kenë një prag më të lartë të tolerancës ndaj kritikës. Prandaj, Gjykata në disa raste ka vlerësuar se liria e shprehjes përfshin edhe publikimin e gjykimeve vlerësuese dhe të mendimeve të shprehura, madje edhe si provokime - kur kjo bëhet me qëllim të nxitjes së debatit publik për funksionimin e institucioneve. Për sa i përket kufizimit të lirisë së shprehjes, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përcakton se gjuha e urrejtjes mund të konsiderohet si bazë për një kufizim të tillë, duke pasur parasysh se është pikërisht gjuha e urrejtjes mund të shkaktojë edhe vepra kriminale të urrejtjes, prandaj sanksionimi i kësaj gjuhe është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike.

Autorët i referohen edhe garantimit të konfidencialitetit të burimeve gazetareske, duke shpjeguar se çdo shkelje e konfidencialitetit të një burimi gazetaresk nuk do të jetë në përputhje me nenin 10, përveç nëse justifikohet nga kërkesat e interesit publik. Parashikimi i interesit publik si bazë për përjashtim nga ky rregull i rëndësishëm është veçanërisht i rëndësishëm për përcaktimin e shkeljeve të të drejtave të tjera absolute të njeriut, siç është, për shembull, e drejta për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor. Në një rast tjetër të GJEDNJ-së, *Sheshiq kundër Kroacisë*¹, Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës nga neni 3 i KEDNJ-së për faktin se shteti nuk ka zbatuar procedurë efektive penale për sulmuesit e ankuesit që ndaj tij kanë kryer veprën penale të urrejtjes, kurse shteti ishte në gjendje të zbulonte identitetin e tyre, megjithatë është thirrur në anonimitetin e burimit gazetaresk, ku Gjykata vendosi qartë se kur bëhet fjalë për një çështje me interes publik (në këtë rast për të zbuluar autorët e krimin të urrejtjes), konfidencialiteti i burimit gazetaresk nuk paraqet pengesë për realizimin e të drejtave të tjera thelbësore dhe absolute.

1 Šečić v. Croatia, 40116/02, 31 Maj 2007.

Autorët analizojnë edhe qëndrimin e GJEDNJ-së në lidhje me mbrojtjen, jo vetëm të përmbajtjes së informacioneve, por edhe të mjeteve të transmetimit të informacioneve, si dhe të drejtën e publikut për të marrë informacione dhe ide me rëndësi publike. Nëpërmjet përzgjedhjes së rasteve të analizuara, autorët në mënyrë specifike i referohen analizës së mbrojtjes së të drejtës për informim nga të dy aspektet, si përmes mbrojtjes së gazetarëve dhe profesionit gazetaresk, ashtu edhe përmes mbrojtjes së të drejtës së qytetarëve për të qenë në mënyrë adekuate të informuar për tema të rëndësishme. Autorët shpjegojnë qartë se praktika e GJEDNJ-së përcakton se kjo e drejtë nuk i mbron vetëm gazetarët, por edhe shkrimtarët, studiuesit akademikët, artistët, kolumnistët, bloggerët dhe përdoruesit e rrjeteve sociale, të cilët kanë ndikim në krijimin e opinionit publik. Të gjitha këto postulate janë të lidhura me lirinë e shtypit, që mundëson lirinë e debatit politik, e cila, nga ana tjetër, siç theksojnë autorët, përfaqëson “thelbin e konceptit të një shoqërie demokratike që mbizotëron në të gjithë strukturën e Konventës”.

Nga ana tjetër, autorët u referohen edhe kërkesave të KEDNJ-së lidhur me detyrimet dhe përgjegjësitë që ndërlidhen me profesionin e gazetarisë dhe konceptin e “gazetarisë së përgjegjshme” si një veprimtari profesionale, e cila gëzon mbrojtje nga neni 10 i Konventës. Kërkesa thelbësore e gazetarisë së përgjegjshme në këtë aspekt është respektimi i dispozitave ligjore në lidhje me kufizimet e përmendura në paragrafin e dytë të nenit 10 të KEDNJ-së, e të cilat rregullohen nga e drejta penale e shtetit.

Autorët shpjegojnë se, sipas praktikës së GJEDNJ-së, mbrojtja e gazetarëve në lidhje me informacionet për çështje me interes të përgjithshëm i nënshtrohet kushtit që gazetarët të veprojnë në mirëbesim dhe mbi një bazë të saktë faktike, respektivisht të ofrojnë informacione “të besueshme dhe të sakta” në përputhje me etikën gazetareske. Gjykata u kërkon gazetarëve që t’i verifikojnë “në mënyrë të arsyeshme” informacionet që ia transmetojnë publikut. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në ditët e sotme, kur shfaqja e lajmeve të rreme kundërshton drejtpërdrejt pikërisht këto kërkesa të Gjykatës, sepse për arsye të caktuara, kryesisht politike, gazetaria dhe mediat keqpërdoren pikërisht për të përhapur informacione të pasakta, në kundërshtim me parimin e mirëbesimit dhe me qëllim të qartë për shkaktimin e destabilizimit politik në vend. Është veçanërisht e rëndësishme të shihet se si do të reflektohet praktika e GJEDNJ-së në lidhje me raste të tilla të lajmeve të rreme përmes të cilave sulmohen institucionet demokratike të vendit duke përdorur mekanizmat e demokracisë (liria e shprehjes).

Autorët në mënyrë të detajuar i analizojnë katër aktgjykimet e GJEDNJ-së për RMV-në, në të cilat Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së, edhe atë: *Selmani dhe të tjerët* (2017), *Makraduli* (2018), *Gelevski* (2020) dhe *Kostova dhe Apostolov* (2022). Autorët theksojnë se rasti i parë nga vendi ynë, ku ankuesi është ankuar për shkelje të cilat, në njëfarë forme mund të ndërlidhen me lirinë e shprehjes, është rasti *Popovski* (2013), por GJEDNJ-ja në këtë rast nuk ka konstatuar shkelje të nenit 10, por shkelje të nenit 8 dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Autorët i analizojnë këto katër aktgjykime nga të gjitha aspektet. Në fakt, e sqarojnë gjendjen faktike që ka rezultuar me ankesë pranë GJEDNJ-së, dispozitat dhe parimet juridike mbi të cilat Gjykata e ka bazuar aktgjykimin, e komentojnë secilin aktgjykim, duke e shpjeguar rëndësinë e tij për rendin juridik të RMV-së, si dhe japin të dhëna rreth asaj nëse dhe në çfarë mënyre është ekzekutuar aktgjykimi.

Autorët i referohen aktgjykimit të GJEDNJ-së për rastin *Selmani dhe të tjerët* (2017), i cili është edhe rasti i parë në të cilin Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së në vendin tonë. Rasti ka të bëjë me pengimin e raportimit të gazetarëve nga seanca e Kuvendit, të datës 24 dhjetor 2012, në të cilën diskutohet për Buxhetin e vitit 2013 dhe, në të cilën, për shkak të atmosferës së tensionuar, kryetari i Kuvendit ka kërkuar ndërhyrjen e shërbimit të sigurisë, i cili i ka larguar nga salla, jo vetëm përfaqësuesit e opozitës, por edhe gazetarët që raportnin nga galeria e sallës së Kuvendit. Në këtë aktgjykim, GJEDNJ-ja konstaton se largimi i gazetarëve nga Galeria e Kuvendit nuk ishte i domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe as nuk kishte një “nevojë urgjente shoqërore” për të. Është interesante të theksohet se në këtë rast, Gjykata, kur vendosi për tre standardet juridike në lidhje me kufizimin e nenit 10, përcaktoi se kufizimi kishte qenë i parashikuar me ligj, se masa e kufizimit kishte për qëllim arritjen e qëllimit legjitim (ofrimi i sigurisë publike dhe parandalimi i trazirave të mëdha), megjithatë, Gjykata konstatoi se standardi i tretë nuk ishte plotësuar duke vlerësuar se një masë e tillë nuk ka qenë e domosdoshme në një shoqëri demokratike e as, nga ana tjetër, nuk ka pasur nevojë urgjente shoqërore për të. Autorët e analizës sqarojnë se për herë të parë dhe të vetme tani për tani, në një rast të vendit tonë, theksohet e drejta e gazetarëve dhe përfaqësuesve të mediave në përgjithësi për të hyrë në lokacione dhe informacione, me qëllim për të marrë njohuri “nga dora e parë” të bazuar në përvojën e tyre të drejtpërdrejtë personale të ngjarjeve se kush duhet të informojë publikun. Ky është një rast shumë i rëndësishëm, në të cilin GJEDNJ-ja i ka marrë parasysh të gjitha argumentet dhe ka adresuar kundërshtimin e shtetit, në të cilin është pohuar se shërbimi i sigurisë i ka larguar gazetarët nga salla për t’i mbrojtur ata, duke shpjeguar se në sallë ishin hedhur gjësende dhe ky veprim ka mundur t’i dëmtojë gazetarët. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim, por megjithatë ka vlerësuar se gazetarët nuk kanë qenë në rrezik për shkak se raportnin nga galeria, e cila është larg nga pjesa e sallës ku kanë ndodhur ngjarjet. Gjykata në këtë rast ka konstatuar shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së dhe ka caktuar dëmshpërblim për ankuesit. Siç shpjegohet në analizë, ekzekutimi i këtij vendimi të GJEDNJ-së është mbyllur plotësisht me një rezolutë të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Gjatë analizimit të këtij rasti, autorët i kanë identifikuar të gjitha elementet e rëndësishme mbi bazën e të cilave GJEDNJ-ja ka vendosur një ekuilibër midis interesave konfliktuale të ruajtjes së sigurisë dhe të drejtës për raportim të gazetarëve dhe arriti në përfundimin se në rastin konkret masa e kufizimit të nenit 10 të KEDNJ-së nuk ka qenë proporcionale dhe e domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Më tej, autorët i referohen aktgjykimit të GJEDNJ-së për rastin *Makraduli* (2018), i cili i referohet ndjekjes penale për shpifje të deputetit dhe nënkryetarit të një partie politike, i cili ka parashtruar pyetje të caktuara në një konferencë partiake për shtyp për indikacione për keqpërdorim të mundshëm të pozitës zyrtare nga shefi i atëhershëm i Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit (DSK), i cili ka ngritur kallëzim penal për shpifje kundër deputetit dhe kështu deputeti është dënuar për këtë veprë, ndonëse ekzekutimi i sanksionit ishte ndërprerë më vonë nga Gjykata, për faktin se, në ndërkohë, veprat penale “shpifje” dhe “ofendim” ishin dekriminalizuar dhe fshirë nga Kodi Penal. Ky aktgjykim është shumë i rëndësishëm sepse ka të bëjë me lirinë e shprehjes politike në një shoqëri demokratike. Në këtë rast, GJEDNJ-ja publikisht ka konstatuar se fjalimi politik mund të kufizohet në raste shumë të rralla dhe se në një shoqëri demokratike pritet debat publik, veçanërisht në lidhje me punën e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore. Ky aktgjykim përcakton se kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjera për zyrtarët shtetërorë sesa për individët privatë, ndërkohë që autorët e analizës e nënvizojnë edhe Mendimin e veçuar të gjyqtarit Wojtuçek (Wojtyczek),

në të cilin theksohet se demokracia vetvetiu nënkupton se garancitë e larta për lirinë e fjalës politike, të vendosura nëpërmjet jurisprudencës së GJEDNJ-së, duhet të vlejnjë jo vetëm për elitat politike që, në parim, u njihen të drejta më të gjera, por edhe për “njerëzit e zakonshëm”. Ky është një aktgjykim shumë i rëndësishëm i GJEDNJ-së, sepse për dallim nga gjykatat e vendit, të cilat i kanë dhënë përparësi mbrojtjes së nderit dhe reputacionit të një funksionari shtetëror, kundrejt të drejtës së deputetit dhe nënkryetarit të partisë opozitare për të bërë pyetje në lidhje me indikacionet për shpërdorim detyre, GJEDNJ-ja ka konstatuar qartë se në një shoqëri demokratike, bartësit e funksioneve publike duhet të jenë tolerantë ndaj kritikave që u bëhen atyre, të mos i drejtohen procedimeve penale kur bëhet fjalë për kritika publike, kurse gjykatat duhet t’i japin përparësi të drejtës së shprehjes edhe ndaj fjalimit dhe debatit politik në vend të nderit dhe reputacionit të bartësve të posteve publike. Këto gjetje të GJEDNJ-së ishin veçanërisht të rëndësishme për vendosjen e praktikave të reja në RMV në lidhje me kritikën publike ndaj bartësve të funksioneve publike dhe në lidhje me debatin politik, i cili është thelbësor në një shoqëri demokratike. Autorët shpjegojnë se edhe ky gjykim është zbatuar plotësisht.

Një aktgjykim i ngjashëm i GJEDNJ-së gjendet në rastin *Gelevski kundër Maqedonisë së Veriut* (2020), në të cilin njihet kontributi i kolumnistëve si krijues të opinionit publik në debatin aktual politik për një çështje me interes publik. Aktgjykimi i referohet një procedimi penal kundër ankuesit të iniciuar nga një gazetar dhe redaktor i njohur në publikun vendas për shkak të një gjykimi vlerësues të shprehur nga ankuesi në kolumnën e tij të rregullt të botuar në një gazetë vendase. Në këtë aktgjykim, GJEDNJ-ja ka konstatuar se shqiptimi i dënimit me burg në raste të tilla mund të jetë në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar nga neni 10 i Konventës vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, respektivisht vetëm kur cenohen rëndë të drejtat e tjera themelore, si p.sh. rastet e gjuhës së urrejtjes ose të nxitjes së dhunës. Gjykata, në këtë aktgjykim, tregon qartë se vetëm gjuha e urrejtjes dhe nxitja e dhunës mund të jenë arsye për sanksionimin e lirisë së shprehjes deri në masën që mund të parashikohet dënimi me burg. Ky aktgjykim është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të dy elementeve:

- 1. Gjykata ka konstatuar se mbrojtja e lirisë së shprehjes i përfshinë edhe kolumnistët në të njëjtën mënyrë si gazetarët, dhe**
- 2. Gjykata ka konstatuar se vetëm gjuha e urrejtjes mund të jetë kufizim i lirisë së shprehjes kur shkruhen kolumnat ku shprehen gjykime të autorit. Autorët shpjegojnë se edhe ky aktgjykim, po ashtu, është zbatuar plotësisht.**

Në këtë drejtim, autorët e analizojnë edhe aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Kostova dhe Apostolov kundër Maqedonisë së Veriut*, i cili gjithashtu i referohet një shpifjeje të pretenduar të kryer përmes një medie të shtypur, dhe në të cilin GJEDNJ-ja prononcohet qartë mbi Ligjin për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje (në tekstin e mëtejshëm: LPCOSH). Në fakt, gazetarët Kostova dhe Apostolov janë paditur për shpifje në lidhje me një artikull të botuar në të përjavshmen “Fokus” për keqpërdorim të pretenduar të pozitës zyrtare nga drejtori i atëhershëm i DSK-së, i cili më pas ka iniciuar procedurë civile për shpifje sipas LPCOSH-së, kurse gjykatat vendore të shkallës së parë dhe të dytë i kanë shpallur përgjegjës gazetarët dhe u kanë shqiptuar gjyba në të holla, të cilat gjyba, me të drejtë, janë cilësuar si drakonike nga gazetarët e RMV-së dhe publiku

i gjerë. Autorët e shpjegojnë në mënyrë shumë precize gjetjen kryesore të GJEDNJ-së për këtë rast, e cila përsëri ka konstatuar se gjykatat vendase kanë qenë më të shqetësuara për mbrojtjen e nderit dhe reputacionit të bartësit të funksionit publik kundrejt lirisë së shprehjes së gazetarëve, dhe gjatë kësaj e kanë penguar debatin publik që gazetarët e kanë synuar gjatë botimit të artikullit. Pas rastit gjyqësor *Makraduli* (2018), ky është rasti i dytë në të cilin GJEDNJ-ja vlerëson se gjykatat në RMV, duke përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, më shumë merren me mbrojtjen e reputacionit dhe nderit të politikanëve se sa me lirinë e shprehjes, që është një efekt frenues ndaj gazetarëve dhe individëve të tjerë - qëllimi i të cilëve është të inkurajojnë debatin publik në lidhje me performancën e bartësve të funksioneve publike. Ky aktgjykim i referohet edhe detyrës dhe obligimit të gazetarëve për të raportuar në mënyrë objektive dhe precize, por nuk konstaton shkelje të këtij parimi nga gazetarët për të cilët vlerëson se kanë dashur të nxisin debatin publik, ndërsa në disa raste janë përpjekur t'i konfirmojnë informacionet që ata i kanë karakterizuar si thashetheme dhe si të tilla i kanë publikuar. Gjykata, gjithashtu, ka konstatuar se dënimet e shqiptuara kanë qenë joproportionale dhe kanë pasur efekt frenues për gazetarët. Autorët konkludojnë se ekzekutimi i këtij vendimi vijon ende dhe nuk është përfunduar zyrtarisht para Komitetit të Ministrave.

Katër aktgjykimet e analizuara në këtë Analizë flasin qartë për problemet që kanë të bëjnë me respektimin e lirisë së shprehjes në vend, gjatë periudhës në të cilën vendi karakterizohej si shtet i robëruar. Fakti që dy aktgjykime të GJEDNJ-së u referohen rasteve gjyqësore të përgjegjësisë penale dhe civile të politikanëve dhe gazetarëve për mendime të shprehura, pyetje të parashtruara dhe thashetheme të publikuara për drejtorin e Drejtorisë së atëhershme të Sigurimit dhe Kundërzbulimit, tregon shumë për nivelin e respektimit të lirisë së shprehjes në atë kohë. Gjithashtu, shumë domethënës është fakti se në tre rastet e ofendimit dhe shpifjes (përfshi këtu edhe aktgjykimin për *Gelevski* (2020)), gjykatat vendase në mënyrë shumë të qartë i kanë dhanë përparësi mbrojtjes së reputacionit dhe nderit të personaliteteve publike në dëm të lirisë së shprehjes së gazetarëve, politikanëve dhe kolumnistëve. Aq më tepër, gjatë trazirave në Kuvend më 24 dhjetor 2012, gazetarët i kanë larguar edhe fizikisht nga salla - gjë që i ka penguar drejtpërdrejt të kryejnë veprimtarinë e tyre. Është dëshpërues fakti që në asnjë prej këtyre rasteve Gjykata Kushtetuese e vendit, e cila sipas rendit juridik të brendshëm është më e thirrur të jetë mbrojtëse e lirisë së shprehjes, nuk ka konstatuar shkelje të kësaj të drejte, e cila është thelbësore për një shtet demokratik.

Autorët e theksojnë me kujdes distancën e pamjaftueshme kohore për t'u bërë një vlerësim objektiv se sa kanë ndikuar këto gjykime në përmirësimin e situatës me lirinë e shprehjes në RMV. Megjithatë, ata me të drejtë vërejnë se po manifestohet një trend i reduktimit të padive për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, gjë që tregon rolin edukativ të aktgjykimeve të GJEDNJ-së për praktikën tonë gjyqësore.

Një vend është i lirë kur gazetarët, komuniteti akademik, shkrimtarët, artistët, kolumnistët, bloggerët, por edhe qytetarët e thjeshtë mund të shprehin lirisht mendimin dhe bindjen e tyre. Një liri e tillë e shprehjes duhet të jetë e gjithëpërfshirëse dhe të ushtrohet rregullisht, ndërsa të kufizohet shumë rrallë dhe sipas rregullave strikte në rrethana të jashtëzakonshme. Kur ka shumë përjashtime që e kufizojnë lirinë e shprehjes, dhe aq më tepër kur qëllimi i gjykatave është të mbrojnë reputacionin e bartësve të funksioneve publike kundër debatit publik dhe opinionit kritik, atëherë krijohet një situatë në të cilën liria e shprehjes pothuajse nuk ekziston.

1. HYRJE

1.1. FUSHËVEPRIMI DHE ZBATIMI I NENIT 10 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 10 – Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.
2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e garanton lirinë e shprehjes. Kuptimi i kësaj të drejte është vetvetiu i shpjgueshëm dhe ka njëfarë rëndësie historike. Pas dy luftërave botërore dhe Holokaustit, nga hartuesit e Konventës, liria e shprehjes u riafirmua si një nga vlerat thelbësore të Këshillit të Evropës. Kërkesa për mbrojtje të veçantë në këtë kuptim lidhet me proceset politike në demokraci, si dhe me rolin e lirisë së shprehjes si mjet i pazëvendësueshëm për minoritetet, oponentët politikë, si dhe shoqërinë civile në tërësi, në procesin e debatit publik. Prandaj, kufizimi i kësaj të drejte mund të justifikohet vetëm në raste të “domosdoshmërisë imperative”, ndërsa përjashtimet nga ajo duhet të interpretohen në mënyrë kufizuese. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

“Funksioni mbikëqyrës i Gjykatës e detyron atë t’u kushtojë vëmendje më të madhe parimeve që janë karakteristike për një ‘shoqëri demokratike’. Liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie të tillë, një nga kushtet themelore për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu. Subjekti i paragrafit 2 të nenit 10 është i aplikueshëm, jo vetëm për informacionet ose idetë që perceptohen në mënyrë të favorshme ose konsiderohen jo ofenduese ose nuk janë subjekt i interesit, por, po ashtu, edhe i atyre që ofendojnë, tronditin ose e shqetësojnë publikun, shtetin ose ndonjë pjesë të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjes së hapur, pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo ‘formalitet’, ‘restriktion’ ose ‘dënim’ i vendosur në këtë sferë (e me të cilën do të kufizohej liria e shprehjes) duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim që duhet të arrihet”.²

Kjo qasje ka sjellë në disa metoda interpretuese në praktikën gjyqësore. Në përgjithësi, Gjykata shqyrton nëse ka pengesë në lirinë e shprehjes sipas paragrafit 1 të nenit 10. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konsideron se kufizimi i lirisë së shprehjes mund të shkaktohet nga një shumëllojshmëri e gjerë masash të ndryshme, në përgjithësi nga “kërkesa të ndryshme formale, kushte, kufizime administrative apo dënime të shqiptuara”, të cilat në thelb shkaktojnë një **“efekt ftohës” ose një “efekt frenues” (chilling effect)** në lidhje me ushtrimin e kësaj të drejte. Megjithatë, ekzaminimi bëhet rast pas rasti. Vet pretendimi se një masë e caktuar ka pasur një efekt “ftohës”, pa sqaruar se si do të shkaktohej një efekt i tillë, nuk përbën një bazë të mjaftueshme që ajo të konsiderohet një kufizim për qëllimet e nenit 10 të Konventës. Nga ana tjetër, nëse Gjykata ka përcaktuar se masa ka shkaktuar ose mund të ketë shkaktuar një efekt të tillë, atëherë ekzaminimi vazhdon duke zbatuar tre standardet e mëposhtme:

1. nëse masa e kontestuar është e paraparë me ligj/dispozitë,
2. nëse synon arritjen e një qëllimi legjitim dhe
3. nëse është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike. Në shumë raste para Gjykatës, përgjigjen e pyetjes lidhur me standardin e tretë e përcakton konkluzioni i Gjykatës nëse në rastin konkret janë respektuar standardet e nenit 10 të Konventës.

Standardi i parë është, në thelb, **test i bazës juridike të masës** që është marrë. Ai kërkon që autoritetet nacionale të identifikojnë dispozitën që ofron bazën për pengimin/kufizimin e së drejtës sipas nenit 10. Termi “ligj” në këtë kuptim përfshin gjithashtu të drejtën e pashkruar, në mënyrë që të përfshijë edhe kulturën juridike të shteteve me sisteme juridike precedente. Në këtë kontekst përfshihen edhe rregulloret e organeve të ndryshme administrative dhe profesionale. Që një normë e caktuar të cilësohet si “ligj”, para së gjithash shqyrtohet disponueshmëria dhe parashikueshmëria e saj (respektivisht qartësia). Ose, me fjalë të tjera, dispozita nuk mund të konsiderohet si “ligj”, nëse nuk është formuluar me precizitet të mjaftueshëm për t’i mundësuar individit të rregullojë sjelljen në mënyrën e duhur, respektivisht ai doemos duhet të jetë në gjendje – po qe se është e nevojshme edhe me këshillë juridike – t’i parashikojë në shkallë të arsyeshme pasojat që mund t’i shkaktojë sjellja e tij.

² *Handyside v. the United Kingdom*, 7 December 1976, § 49, Series A no. 24

Kërkesa për ekzistencën e **një qëllimi legjitim**, për shkak të të cilit mund të justifikohet restriksioni/kufizimi i lirisë së shprehjes, në fakt u referohet arsyeve të renditura në nenin 10 paragrafi 2. Ato janë: mbrojtja e sigurisë nacionale, mbrojtja e integritetit territorial, mbrojtja e sigurisë publike, mbrojtja e rendit dhe parandalimi i krimit, mbrojtja e shëndetit, mbrojtja e moralit, mbrojtja e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, parandalimi i përhapjes së të dhënave konfidenciale dhe garantimi i autoritetit dhe i paanshmërisë së pushtetit gjyqësor. Praktikisht, çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të ketë për detyrë arritjen e një prej synimeve konkurruese të renditura në mënyrë taksative, të cilat në rastin e dhënë konsiderohen parësore.

Analiza e Gjykatës mbështetet kryesisht në standardin e tretë, i cili është gjithashtu lakmus test për Gjykatën dhe palët. Në fakt, Gjykata e interpreton në radhë të parë frazën **“domosdoshmëri në një shoqëri demokratike”** si një situatë e cila e presupozon një **“nevojë të domosdoshme shoqërore”**, e cila duhet të plotësohet nga një kufizim që, nga ana tjetër, vendos një ekuilibër të drejtë dhe proporcional midis mjeteve të zgjedhura dhe lirinë e shprehjes të individëve. Megjithëse autoritetet nacionale kanë një marginë të caktuar diskretive (liria e vlerësimit, e njohur gjithashtu si margin of appreciation) kur vlerësojnë ekzistencën e nevojave dhe qëllimeve të tilla shoqërore, si dhe kur zgjedhin masat për t'u marrë me to, shteti, megjithatë, nuk ka fuqi të pakufizuar në këtë kuptim. Në fakt, Gjykata e ruan kompetencën për të vlerësuar nëse ka **“arsye relevante dhe të mjaftueshme”** për të justifikuar masat e pengimit të lirisë së shprehjes: “Detyra e Gjykatës, gjatë ushtrimit të funksionit të saj mbikëqyrës, nuk është të zërë vendin e autoriteteve nacionale kompetente (gjykatave), por t'i shqyrtojë vendimet që kanë marrë në dritën e nenit 10. Kjo nuk do të thotë se mbikëqyrja kufizohet vetëm në përcaktimin nëse shteti i paditur e ka përdorur diskrecionin (lirinë) e tij në mënyrë të arsyeshme, të kujdesshme dhe me vullnet të mirë kur merr vendimin, por ajo që duhet të bëjë Gjykata është të shqyrtojë kufizimin që është objekt i pretendimeve ankimore në dritën e çështjes në tërësi dhe të përcaktojë nëse kjo ka qenë “proporcional me qëllimin legjitim” dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet nacionale (gjykatat) për të justifikuar këtë janë relevante dhe të mjaftueshme”...Duke vepruar kështu, Gjykata duhet të bindet që autoritetet nacionale kanë zbatuar standarde të cilat janë në përputhje me parimet e mishëruara në nenin 10 dhe, për më tepër, nëse ato mbështeteshin në një vlerësim të pranueshëm të fakteve përkatëse.³ Ekziston një përjashtim kur kufizimet e lirisë së shprehjes janë me qëllim të nxitjes së dhunës ndaj një individi, një zyrtari publik ose një pjese të caktuar të popullsisë - atëherë autoritetet shtetërore gëzojnë një marginë diskrecioni më të gjerë (liri vlerësimi) kur e shqyrtojnë nevojën e pengimit të lirisë së shprehjes: “Gjykata përsërit se fakti që “informacione” ose “ide” të caktuara janë ofenduese, tronditëse ose shqetësuese nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të justifikuar këtë kufizim. Megjithatë, ajo që për të cilën bëhet fjalë në këtë rast të veçantë është gjuha e urrejtjes dhe glorifikimi i dhunës”⁴.

Gjykata i kushton vëmendje të veçantë aspektit të **censurës**, veçanërisht asaj që vjen në formën e shqiptimit të një dënimi apo sanksioni të caktuar disproporcional. Kështu, edhe nëse plotësohen të gjitha kushtet tjera, respektivisht një kufizim i caktuar i lirisë së shprehjes të ishte “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike” me qëllim të arritjes së një qëllimi tjetër më të lartë, nëse vetë dënimi përfaqëson një formë të caktuar censurimi që dekurajon (sidomos për shtypin) shprehjen e kritikave, megjithatë, një kufizim i

3 *Hertel v. Switzerland*, 25 August 1998, § 46, *Reports of Judgments and Decisions* 1998-VI

4 *Süreç v. Turkey* (no. 1) [GC], no. 26682/95, § 62, ECHR 1999-IV

tillë nuk do të jetë i pranueshëm për Gjykatën. Prandaj, dënimi i një gazetari, para se teksti të jetë botuar, sipas mendimit të Gjykatës, përbën një formë censurimi që ka të ngjarë ta dekurajojë atë nga hulumtimi i kërkimeve të qenësishme në punën e tij për të përgatitur një artikull të informuar mbi një temë aktuale.⁵ Gjykata, nëpërmjet praktikës së saj, përsërit vazhdimisht se që një masë të konsiderohet proporcionale dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike, është e nevojshme që të mos ketë mjete/masa të tjera më të buta, të cilat do të arrinin të njëjtin qëllim nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, kufizimi i lirisë së shprehjes do të ishte sa më i vogël. Pothuajse sa herë që bëhet një analizë e proporcionalitetit, Gjykata i kushton një rëndësi të veçantë faktit që gjyqtarët vendas gjatë vendimmarrjes kanë zgjedhur masat më pak restriktive nga gama e masave që kanë në dispozicion, respektivisht kanë bërë “dëm” minimal në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara nga neni 10 i Konventës.⁶

Mund të ndodhë që liria e shprehjes të shfaqet si pengesë për ushtrimin e disa të drejtave të tjera të mbrojtura nga Konventa dhe protokollet e saj. Në raste të tilla, Gjykata shqyrton nëse autoritetet nacionale kanë vendosur një ekuilibër të përshtatshëm midis mbrojtjes të së drejtës për lirinë e shprehjes, nga njëra anë dhe, të drejtave ose vlerave të tjera të mbrojtura nga Konventa, nga ana tjetër. Deri më tani, konflikti më i zakonshëm është me të drejtën për respektimin e jetës private (neni 8 i Konventës), e cila përfshin të drejtën për mbrojtjen e reputacionit/nderit/dinjitetit si element i jetës private. Kërkimi për një ekuilibër të drejtë midis të drejtave bëri që Gjykata të miratonte një metodologji specifike për peshimin e dy të drejtave me status të barabartë, e cila zbatohet sa herë që ka një konflikt midis të drejtës së garantuar nga neni 10 i Konventës dhe disa të drejtave të tjera të mbrojtura nga Konventa, në veçanti të drejtat personale, si nderi dhe reputacioni.

Gjykata thekson vazhdimisht se neni 10 mbron **jo vetëm përmbajtjen e informacioneve dhe ideve, por edhe vetë mjetet e transmetimit të tyre**. Prandaj, shtypi gëzon hapësirën më të gjerë të mundshme të mbrojtjes. Nën një mbrojtje të tillë janë përfshirë edhe aktivitetet përgatitore të gazetarëve për botim, hulumtimet që ata bëjnë, si dhe konfidencialitetin e burimeve gazetareske. Roli i mediave si “mbrojtës të publikut” është jetik për proceset politike në një demokraci: “Gjykata rithekson se liria e shprehjes është një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe se kufizimet e vendosura ndaj shtypit janë një vëmendje e veçantë për Gjykatën”.⁷ Shtypi dhe gazetaria investigative garantojnë funksionimin e shëndetshëm të demokracisë, duke ekspozuar vendimet dhe veprimet (ose mosveprimet) politike të qeverive para publikut dhe opinionit publik, duke lehtësuar kështu rolin e qytetarëve në procesin e përzgjedhjes dhe vendimmarrjes.

Ky funksion i mediave është i një rëndësie të veçantë kur shqyrtohet në korrelacion me **të drejtën e publikut për të marrë informacione dhe ide me rëndësi publike**, duke përfshirë edhe ato për tema politike përçarëse: “Megjithëse shtypi nuk duhet të kapërcejë kufijtë e vendosur, ndër të tjera, për hir të “mbrojtjes së reputacionit të të tjerëve”, megjithatë, i njëjti (shtypi) ka detyrimin të përcjellë informacione dhe ide për

5 *Dammann v. Switzerland*, no. 77551/01, § 57, 25 April 2006

6 *Axel Springer AG v. Germany* [GC], no. 39954/08, § 56, 7 February 2012

7 *The Sunday Times v. the United Kingdom* (no. 2), 26 November 1991, § 48, Series A no. 217 ; *Jersild v. Denmark*, 23 September 1994, § 31, Series A no. 298

çështje politike, ashtu sikurse në fushat tjera të interesit publik. Jo vetëm që shtypi ka për detyrë të përcjellë informacione dhe ide të tilla, por edhe publiku ka të drejtë t'i marrë ato.

Për më tepër, liria e shtypit i ofron publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe formuar opinione rreth ideve dhe pikëpamjeve të liderëve politikë. Në fakt, liria e debatit politik është thelbi i konceptit të një shoqërie demokratike, e cila mbizotëron në të gjithë strukturën e Konventës⁸. Madje, edhe jashtë proceseve politike, shtypi ndihmon gjatë formimit të mendimit të informuar publik, e kultivon dhe e stimulon debatin publik kritik për tema me interes të përgjithshëm publik. Për shkak të ndërlidhjes së domosdoshme me demokracinë, vëllimi i lirisë së shtypit duhet të ndërtohet në mënyrën më të gjerë të mundshme, në mënyrë që të lejojë një shkallë të caktuar ekzagjerimi, madje edhe provokimi: “Kështu, hapësira e vlerësimit të lirë të autoriteteve vendase është e kufizuar nga interesi i një shoqërie demokratike për t'i mundësuar shtypit të luajë rolin e tij jetik të ‘mbrojtësit publik’⁹ Prandaj, kur vlerësohen kufizimet e mundshme të lirisë së shtypit, nga Gjykata zbatohet shqyrtim më rigoroz.

Një nivel mjaft të lartë mbrojtjeje gëzojnë studiuesit akademikë si dhe autorët e temave me interes publik. Gjykata, në praktikën e saj të fundit, vëren se duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që e luan interneti dhe rrjetet sociale në përmirësimin e qasjes së publikut në lajme dhe shpërndarjen e informacioneve, funksioni i blogerëve dhe përdoruesve të njohur të mediave sociale mund të barazohet gjithashtu me atë të “kujdestarëve publikë” në kontekst të mbrojtjes së ofruar me nenin 10 të Konventës.

Mbrojtja e shtuar që u jepet “kujdestarëve publikë”, dhe veçanërisht shtypit, sipas nenit 10 të Konventës, u nënshtrohet gjithashtu disa kushteve të caktuara dhe, mbi të gjitha, nënkupton që ata duhet të respektojnë **“detyrat dhe përgjegjësitë”** që lidhen me profesionin e gazetarit, si detyrim ndaj **“gazetarisë së përgjegjshme”**. Koncepti i “gazetarisë së përgjegjshme”, si një veprimtari profesionale, e cila gëzon mbrojtje nga neni 10 i Konventës, nuk kufizohet vetëm në përmbajtjen e informacioneve që mblidhen dhe/ose shpërndahet me mjete gazetareske. Ky koncept mbulon, ndër të tjera, edhe ligjshmërinë e sjelljes së gazetarit, duke përfshirë ndërveprimin e tij publik me autoritetet në lidhje me kryerjen e rolit gazetaresk. Fakti nëse gazetari ka shkelur një normë të caktuar ligjore është ndoshta më i rëndësishmi, megjithëse jo edhe vendimtar, në përcaktimin nëse ai ka vepruar me përgjegjësi në ushtrimin e profesionit të tij: “Gjykata përsërit në këtë kontekst se gazetarët që ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes marrin përsipër ‘detyrime dhe përgjegjësi’”. Në lidhje me këtë, rikujtohet se paragrafi 2 i nenit 10 nuk e garanton lirinë e përgjithshme të pakufizuar të shprehjes, edhe në lidhje me raportimin e mediave për çështje që shkaktojnë brengosje publike serioze. Në veçanti dhe pavarësisht nga roli jetik që luajnë mediat në një shoqëri demokratike, gazetarët, në parim, nuk mund të lirohen nga detyrimi i tyre për të respektuar ligjin e zakonshëm penal mbi bazën se si gazetarë, neni 10 u jep atyre mbrojtje të “çeliktë”. Me fjalë të tjera, një gazetar nuk mund të kërkojë imunitet ekskluziv nga përgjegjësia penale për arsyen e thjeshtë se, ndryshe nga individët e tjerë që ushtrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, vepra në fjalë është kryer gjatë kryerjes së funksionit të tij gazetaresk.¹⁰

8 *Lingens v. Austria*, 8 July 1986, §§ 41 and 42, Series A no. 103

9 *Radio France and Others v. France*, no. 53984/00, § 33, ECHR 2004-II

10 *Pentikäinen v. Finland* [GC], no. 11882/10, § 91, ECHR 2015

Mbrojtja e parashikuar nga neni 10 për gazetarët në lidhje me informacionet për çështje të interesit të përgjithshëm i nënshtrohet kushtit që gazetarët të veprojnë në mirëbesim dhe mbi baza të sakta faktike, respektivisht të sigurojnë informacione “të besueshme dhe të sakta” në përputhje me etikën gazetareske. Këto qëndrime luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm në ditët e sotme, duke pasur parasysh ndikimin që mediat kanë në shoqërinë moderne, që konsiston jo vetëm në informimin e thjeshtë, por edhe në formësimin e opinionit publik. Me gazetari “të përgjegjshme”, Gjykata nënkupton që gazetarët duhet të kontrollojnë “në mënyrë të arsyeshme” informacionet që i japin publikut. Megjithatë, nëpërmjet praktikës së saj, Gjykata pranon se metodat e raportimit objektiv dhe të balancuar mund të ndryshojnë ndjeshëm në varësi të mediumit që e transmeton informacionin.

Siç u përmend më lart, liria e shtypit nënkupton gjithashtu përdorimin e një shkalle të caktuar ekzagjerimi, madje edhe provokimi. Prandaj, Gjykata thekson se nuk është detyrë as e Gjykatës dhe as e gjykatave vendase të vendosin se çfarë teknike raportimi duhet të zbatohet në çdo rast individual. Gazetarët gëzojnë lirinë për të zgjedhur në mënyrë të pavarur informacionet që u vijnë, me cilën prej tyre dhe në çfarë mënyre do të merren.

Përfundimisht, Gjykata vlerëson se metoda dhe mjetet e përdorura për marrjen e një informacioni të caktuar për t’ia plasuar publikut, si dhe respekti i treguar ndaj personit që është subjekt i informacionit, janë gjithashtu kritere thelbësore që duhen marrë parasysh, kur përkufizohet nocioni i gazetarisë së përgjegjshme. Të njëjtat vërejtje vlejné edhe për redaktorët dhe për botuesit. Në fakt, sipas Gjykatës, ato u ndihmojnë autorëve që t’u ofrojnë media për shprehjen e ideve të tyre, ndaj me këtë fakt, ata i ndajnë të njëjtat “detyra dhe përgjegjësi” sikurse autorët. Prandaj, nuk përjashtohet “ndëshkim” i këtyre personave për shkak të një teksti të botuar, madje edhe kur ata nuk janë personalisht të lidhur me tekstin dhe as nuk pajtohen me mendimet e shprehura të autorit.¹¹ Edhe pse për shkak të natyrës së veçantë të internetit, shkalla e përgjegjësisë së portaleve në internet mund të ndryshojë nga ajo e mediave tradicionale, megjithatë për vetë faktin se portali ofron një forum për ushtrimin e lirisë së shprehjes duke mundësuar transmetimin e informacioneve dhe ideve për publikun, “detyrat dhe përgjegjësitë” vlerësohen në dritën e parimeve që zbatohen edhe për mediat tradicionale¹². Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse merret parasysh se sasia e informacioneve që disponohet ekskluzivisht përmes internetit është vazhdimisht në rritje, si dhe fakti që më së shpeshti informacionet që injorohen nga mediat tradicionale shpërndahen në internet dhe, kështu, ato nxisin shfaqjen e të ashtuquajturës gazetari qytetare.

Çelësi për lirinë e shtypit është sigurimi i **konfidencialitetit të burimeve gazetareske**¹³. Pa këtë mbrojtje, rrezikohet roli i shtypit në sigurimin e informacioneve të sakta për publikun dhe formimin e një publiku të mirëinformuar. Çdo shkelje e konfidencialitetit të një burimi gazetaresk nuk do të jetë në përputhje me nenin 10, përveç nëse justifikohet nga kërkesat e interesit publik. Në të kundërtën e kësaj, nuk konsiderohet e papajtueshme me nenin 10- t’i kërkohet gazetarit të sigurojë një bazë faktike në mbështetje të

11 *Orban and Others v. France*, no. 20985/05, § 47, 15 January 2009

12 *Delfi AS v. Estonia* [GC], no. 64569/09, § 109, ECHR 2015

13 *Goodwin v. the United Kingdom*, 27 March 1996, § 33, *Reports of Judgments and Decisions* 1996-II

deklaratave të supozuara shpifëse, të cilat janë përshkruar si gjykime vlerësuese, për sa kohë që kjo detyrë nuk shkon aq larg sa të kërkojë zbulimin e identitetit të burimev¹⁴.

1.2. RASTET E MAQEDONISË PARA GJEDNJ LIDHUR ME LIRINË E SHPREHJES DHE SIGURINË E GAZETARËVE

Deri më tani, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka shqiptuar vetëm 4 (katër) aktgjykime që i referohen nenit 10 të Konventës. Ndër to janë edhe rastet: *Selmani e të tjerë*,¹⁵ *Makraduli*,¹⁶ *Gelevski*¹⁷ dhe *Kostova dhe Apostolov*¹⁸. Në të gjitha këto raste është konstatuar shkelje e nenit 10 të KEDNJ-së.

Përndryshe, aktgjykimi i parë për vendin tonë në të cilin GJEDNJ merret me lirinë e shprehjes në përgjithësi është *Popovski*.¹⁹ Fokusi i këtij rasti ishte në procedurën penale të iniciuar pasi parashtruesi i kërkesës parashtrroi një kallëzim penal privat për shpifje të pretenduar kundër kryeredaktorit të “Utrinski Vesnik” dhe gazetarit që ishte autor i artikullit kontestues në atë gazetë. Megjithatë, në këtë rast, pretendimet ankimore të aplikantit lidhur me rezultatin e pafavorshëm, respektivisht ndërprerja e procedurës penale të nisur, nuk janë shqyrtuar sipas nenit 10, por vetëm nga aspekti i nenit 8 të Konventës, me të cilin garantohet e drejta e respektimit për jetën private dhe familjare.

GJEDNJ-ja fillimisht konstaton se në këtë rast ka ndodhur shkelje e nenit 6 paragrafi 1 i Konventës, me të cilin mbrohet e drejta e gjykitimit të drejtë sa i përket mospërmbushjes së kërkesës për “gjykim në afat të arsyeshëm”.²⁰ Njëherësh është përcaktuar edhe se si pasojë e vonesës së konsiderueshme të vendimit penal të kontestuar, aplikanti ka qenë i penguar të gëzonte mbrojtje efektive të së drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private, që dukshëm ishte shkelur ndjeshëm. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se mënyra e zbatimit të mekanizmit penalo-juridik në këtë rast ka qenë me mangësi, deri në masën që paraqet shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit sipas nenit 8 të Konventës. Si pasojë e kësaj është konstatuar shkelje e nenit 8 të KEDNJ-së.²¹

Pothuajse 20 vjet do të kalojnë nga data e ratifikimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, më 10 prill 1997 nga Republika e atëhershme e Maqedonisë, deri në aktgjykimin e parë të GJEDNJ-së, e cila do të vendosë në mënyrë meritore për pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me nenin 10 të Konventës. Në fakt, aktgjykimi më domethënës i GJEDNJ-së, sa i përket sigurisë së gazetarëve në kontekstin e

14 *Katamadze v. Georgia*, no. 12979/04, ECtHR decision of 5 June 2007, § 42

15 *Selmani and Others v. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, no. 67259/14, 9 February 2017

16 *Makraduli v. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, nos. 64659/11 and 24133/13, 19 July 2018

17 *Gelevski v. North Macedonia*, no. 28032/12, 8 October 2020

18 *Kostova and Apostolov v. North Macedonia*, no. 38549/16, 5 April 2022

19 *Popovski v. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, no. 12316/07, 31 October 2013

20 Paragrafi 70 i aktgjykitimit.

21 Paragrafët 91 dhe 92 nga aktgjykimi.

vendit tonë, *Selmani dhe të tjerët*²², paraqet edhe rastin e parë të Maqedonisë në të cilin GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 10 të Konventës.

Siç fare dihet mirë, ky rast kishte të bënte me largimin me forcë të gazetarëve nga galeria e Kuvendit – incident ky që ndodhi më 24 dhjetor 2012, teksa ata po raportnin për debatin parlamentar për Buxhetin e vitit 2013 në një atmosferë mjaft të tensionuar të ndjekur nga protesta jashtë ndërtesës së Kuvendit, si dhe me tensione dhe prishje të rendit brenda ambienteve të tij, që kulmoi me ndërhyrjen e shërbimit të sigurimit parlamentar. Me këtë vendim, GJEDNJ-ja deklaroi se largimi i gazetarëve nga galeria parlamentare nuk ishte i domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe as nuk ekzistonte një “nevojë e domosdoshme shoqërore” për të.

Ky aktgjykim është vendimtar për të theksuar rëndësinë e profesionit të gazetarisë në drejtim të raportimit për çështje me interes të caktuar publik legjitim, si dhe rolin e mediave për të ndarë informacione rreth zhvillimeve të rëndësishme politike dhe shoqërore dhe të drejtën e publikut për të marrë informacione të tilla. Në fakt, me të, për herë të parë, dhe tani për tani të vetmin në rast gjyqësor të Maqedonisë, theksohet e drejta e gazetarëve dhe përfaqësuesve të mediave në përgjithësi për të hyrë në lokacione dhe informacione në mënyrë që të marrin njohuri “të dorës së parë” bazuar në përvojën e tyre të drejtpërdrejtë personale për ngjarje për të cilat duhet ta informojnë publikun.

Në këtë mënyrë, ky aktgjykim i udhëzon institucionet nacionale që duhet të ofrojnë sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik në masën e nevojshme që ata të jenë në gjendje të përmbushin detyrën e tyre profesionale dhe të raportojnë për ngjarje me interes të jashtëzakonshëm publik.

Vëmendje e veçantë në kontekstin e lirisë së shprehjes politike dhe rolit të përfaqësuesve të partive politike, e mbi të gjitha të opozitës, në hapjen dhe zhvillimin e debateve kritike për mënyrën e kryerjes së funksioneve shtetërore, ka aktgjykimi për rastin *Makraduli*. Ky shfaqet si një aktgjykim referues i GJEDNJ-së në një rast të Maqedonisë, kur është fjala për lirinë e shprehjes politike në një shoqëri demokratike. Prandaj, edhe pse nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me gazetarët, ky aktgjykim, megjithatë, do të përfshihet në këtë analizë, duke u nisur nga rëndësia e tij për gëzimin e plotë dhe efektiv të lirisë së shprehjes në kuptimin më të gjerë të fjalës.

Për dallim nga *Selmani dhe të tjerët*, *Kostova dhe Apostolov*, si dhe *Gelevski*, i referohen një shpifjeje të supozuar të kryer përmes një mediumi të shtypur.

Nga ana tjetër, në rastin *Gelevski*,²³ aplikanti që ka qenë kolumnist në gazetën e përditshme “Utrinski Vesnik”, u dënua penalisht për shpifje për artikullin e tij, në të cilin ai ka kritikuar një gazetar tjetër dhe kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës të një mediumi për punën e tij dhe lidhjen me qeverinë e atëhershme.

22 *Selmani and Others v. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, no. 67259/14, 9 February 2017

23 *Gelevski v. North Macedonia*, no. 28032/12, 8 October 2020

Në këtë aktgjykim njihet kontributi i kolumnistëve si krijues të opinionit publik në debatin aktual politik për një çështje me interes publik.²⁴

Ndryshe nga rasti *Gelevski*, i cili i referohet dënimit penal të aplikantit, shkelja e nenit 10 në rastin *Kostova dhe Apostolov* është e lidhur me rezultatin e procedurës civile për shpifje. Pikërisht për këtë, ky rast për herë të parë i dha mundësinë GJEDNJ-së që të vendosë për mënyrën e zbatimit të Ligjit për përgjegjësinë civile për ofendim dhe shpifje (LPCOSH) i miratuar më 12 nëntor 2012,²⁵ i cili ka hyrë në fuqi më 21 nëntor 2012. Në fakt, në këtë mënyrë GJEDNJ-ja e testoi respektimin e standardeve evropiane në këtë sferë pas përfundimit të procesit të dekriminalizimit të ofendimit dhe shpifjes. Në të njëjtën kohë, ky gjykim thekson rëndësinë e “detyrave dhe përgjegjësi” të gazetarëve dhe redaktorëve të mediave.

Të gjitha këto raste të përmendura më lartë do të trajtohen më në detaje në pjesën e mëtejshme të kësaj analize, me fokus të veçantë në çështjet me të cilat ato merren.

24 Paragrafi 25 nga aktgjykimi.

25 Ligji për përgjegjësi për ofendim dhe shpifje (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 143/2012, e dt. 14 nëntor 2012)

2. REZYME E RASTEVE TË MAQEDONISË PARA GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME LIRINË E SHPREHJES DHE SIGURINË E GAZETARËVE

2.1. SELMANI DHE TË TJERËT²⁶

Fakte për rastin

Rasti *Selmani dhe të tjerët* i referohet largimit të aplikantëve nga galeria e Kuvendit, si ambient i caktuar për gazetarët e autorizuar për të raportuar për punën e Kuvendit. Në fakt, gjatë debatit parlamentar më 24 dhjetor 2012 për miratimin e Ligjit për buxhetin e shtetit për vitin 2013, ka ndodhur një incident në të cilin kanë marrë pjesë më shumë deputetë - që ka sjellë një atmosferë të tensionuar brenda dhe jashtë Kuvendit. Vetë ngjarja ka tërhequr vëmendje të konsiderueshme mediatike. Atmosfera e tensionuar ka arritur kulmin kur një grup deputetësh kanë shkaktuar rrëmujë në sallën e kuvendit. Sipas gjendjes së pakontestueshme faktike, ata e kanë rrethuar kryetarin e Kuvendit dhe kanë krijuar zhurmë duke e goditur tavolinën e tij, si dhe kanë penguar qasjen në foltore në atë mënyrë që kanë filluar të shkatërrojnë pajisjet teknike. Duke marrë parasysh rrethanat, kryetari i Kuvendit u ka dhënë urdhër shërbimeve të sigurisë që të ndërmarrin masa për vendosjen e rendit dhe funksionimin e duhur të Kuvendit. Menjëherë pas kësaj, në sallë kanë hyrë anëtarët e shërbimit të sigurisë së Kuvendit, të cilët e kanë tërhequr kryetarin nga salla dhe kanë filluar t'i largojnë me forcë deputetët e opozitës. Në të njëjtën kohë, në galerinë ku kanë qëndruar aplikantët kanë hyrë edhe zyrtarë tjerë të sigurisë dhe kanë filluar t'i largojnë aplikantët dhe gazetarët e tjerë të pranishëm. Përderisa disa gazetarë u janë bindur urdhrave të zyrtarëve dhe janë larguar nga ky ambient, aplikantët nuk kanë pranuar të largohen, pasi situata në sallën e parlamentit ishte përshkallëzuar dhe ata kanë vlerësuar se publiku kishte të drejtë të informohej për atë që po ndodhte në sallë. Megjithatë, në fund, aplikantët janë larguar me forcë nga galeria nga zyrtarët e sigurisë.

26 *Selmani and Others v. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, no. 67259/14, 9 February 2017

Menjëherë pas ngjarjeve në Kuvend, më 26 dhjetor 2012, Shoqata e Gazetarëve i ka dërguar shkresë Sektorit të Kontrollit të Brendshëm pranë MPB-së, me të cilën ka kërkuar të përcaktohet përgjegjësia për personat që morën pjesë në largimin e tyre nga galeria, dhe të cilët, në këtë mënyrë, ua kanë shkelur të drejtat e garantuara nga neni 10 i Konventës. Kërkesa e tyre është refuzuar nga Sektori i Kontrollit të Brendshëm, me arsyetimin se largimi i gazetarëve nga galeria ka qenë në përputhje me nenin 43 të Ligjit për Kuvendin, respektivisht se shërbimi parlamentar i sigurisë ka vepruar me qëllim që të rikthejë rendin dhe të vazhdojnë të zhvillohen diskutimet.

Ndërkohë, më 14 qershor 2013, Presidenti i Shtetit ka ngritur një komision hetimor Ad-hoc, i cili kishte për qëllim hetimin e ngjarjeve dhe incidenteve në Kuvend të datës 24 dhjetor 2012. Komisioni përbëhej nga pesë anëtarë vendas (dy prej tyre deputetë), si dhe dy vëzhgues të jashtëm të emëruar nga Bashkimi Evropian. Në raportin e tij të datës 26 gusht 2013, Komisioni arriti në përfundimin se mungesa e procedurave të duhura për trajtimin e situatave të tilla, duke përfshirë mungesën e një strategjie për trajtimin e përfaqësuesve të mediave në situata krize, çoi në një situatë në të cilën gazetarët u larguan nga galeria e parlamentit, me çka iu shkelën të drejtat e tyre të lirisë së informimit publik dhe opinionit në punën e Kuvendit. Si përfundim, Komisioni rekomandoi që Parlamenti të jetë veçanërisht i vëmendshëm dhe i hapur ndaj mediave, për të raportuar dhe zbatuar praktikën më të mira evropiane në këtë çështje.

Aplikantët në Gjykatën Kushtetuese kanë parashtruar një iniciativë për mbrojtjen e të drejtave të garantuara me kushtetutë, në të cilën ata kanë theksuar se të drejtat e tyre nga neni 10 i Konventës janë shkelur nga sjellja e shërbimeve të sigurisë së Kuvendit në ditën kritike. Ata i janë referuar faktit se diskutimi parlamentar dhe ngjarjet lidhur me miratimin e buxhetit të shtetit ishin me interes të veçantë publik. Ndaj, ndërhyrja e shërbimeve të sigurimit të Kuvendit, në kuptimin e largimit fizik të tyre nga galeria, nuk ka qenë as “ligjore” dhe as “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”. Aplikantët e kanë kontestuar edhe bazën ligjore mbi të cilën është kryer ndërhyrja, respektivisht ata kanë konsideruar se neni 43 i Ligjit për Kuvendin nuk mund të interpretohet gjerësisht në atë mënyrë që të lejojë largimin me forcë të gazetarëve nga galeria e Kuvendit, me qëllim vendosjen e rendit. Nga pikëpamja e domosdoshmërisë së masave të aplikuara në rrethanat specifike, ata kanë pohuar se në momentin kritik kanë qenë në galeri dhe nuk kanë pasur kontakte as me kryetarin e Kuvendit dhe as me deputetët. Prandaj, nuk mund të kenë kontribuar në prishjen e rendit të punës së Kuvendit. Ata i kanë bërë thirrje Gjykatës Kushtetuese që të mbajë seancë publike në përputhje me nenin 55 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese dhe të konstatojë shkelje të nenit 16 të Kushtetutës dhe nenit 10 të Konventës.

Nga ana e saj, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj, ka konstatuar se baza ligjore për masën e kontestuar ishte neni 43 i Ligjit për Kuvendin, në të cilin përcaktohet saktë se kush është përgjegjës për mbajtjen e rendit në objektin e Kuvendit, si dhe se urdhrat e kryetarit të Kuvendit kanë vlejtur njësoj si për deputetët, po ashtu edhe për të gjithë personat e jashtëm që kanë marrë pjesë në punën e Kuvendit (përfshirë edhe gazetarët në galeri). Në pjesën për domosdoshmërinë e masës, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se ajo duhet të shqyrtohet në lidhje me rrethanat specifike të rastit, përkatësisht ngjarjet që kanë ndodhur brenda godinës së Kuvendit, si dhe rrëmujën jashtë Kuvendit. Gjykata Kushtetuese e ka theksuar veçanërisht faktin se gjatë incidenteve janë dëmtuar mobilitet, që ka kulminuar me hedhjen e gjëseneve në sallën e

Kuvendit, por edhe në drejtim të galerisë. Prandaj, Gjykata nxori përfundimin se masat e ndërmarra kishin për qëllim kryesisht mbrojtjen e gazetarëve në galeri, përkatësisht zhvendosjen e tyre në një vend më të sigurt, ku ata nuk do të ishin në rrezik. Gjykata Kushtetuese nuk ka parë asnjë pengesë në lirinë e shprehjes për faktin se gazetarët i kanë dorëzuar dhe publikuar me kohë raportet e tyre për ngjarjet në Kuvend, në edicionet e mbrëmjes të mediave të tyre.

Të pakënaqur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka vepruar në shkallën e parë dhe të vetme, aplikantët kanë parashtruar aplikacion në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Aplikantët para Gjykatës kanë deklaruar se largimi i tyre nga galeria e parlamentit nuk ishte “në përputhje me ligjin”, respektivisht se dispozitat e Ligjit për Kuvendin kanë qenë të paparashikueshme. Konkretisht, neni 43 i ligjit nuk u ka dhënë diskrecion të plotë shërbimeve të sigurisë së Kuvendit për zgjedhjen e masave që duheshin ndërmarrë për të ruajtur rendin në Kuvend e as, nga ana tjetër, nuk u ka dhënë të drejtën e përdorimit të forcës ndaj gazetarëve që refuzuan të largohen nga galeria. Aplikantët, po ashtu, kanë pohuar se nuk ka pasur asnjë “nevojë urgjente shoqërore” për largimin e tyre nga galeria. Ata nuk kanë qenë në rrezik dhe as vetë nuk janë ndjerë të kërcënuar nga situata për shkak se galeria ishte e ndarë fizikisht nga salla plenare. Sipas kësaj, masa ka pasur efekt “ftohës”. Krahas pretendimeve të ankimit, të cilat i referoheshin nenit 10 të Konventës, aplikantët i kanë theksuar edhe pretendimet ankimore në lidhje me nenin 6 të Konventës, respektivisht kanë konsideruar se vetë fakti që Gjykata Kushtetuese nuk e ka pranuar kërkesën e tyre për të zhvilluar një dëgjim publik gjatë procesit të vendimmarrjes, ajo e ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë.

Gjetje të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata, nga ana e saj, së pari e ka shqyrtuar çështjen e shkeljes së pretenduar të nenit 6 të Konventës (e drejta për një gjykim të drejtë). Fillimisht, ajo që duhej përcaktuar ishte nëse e drejta për t'u informuar nga Kuvendi mund të konsiderohej një “e drejtë civile” për qëllimet e Konventës. Gjykata nxori këtë konkluzion: “Liria e mediave për të raportuar për aktivitetet në Kuvend është e specifikuar më tej në Rregulloren e Kuvendit. Kjo që është theksuar më sipër mjafton që Gjykata të arrijë në përfundimin se ligji nacional e njej të drejtën e gazetarëve të akredituar për të raportuar nga Parlamenti. Raportimi nga galeria e Parlamentit ka qenë ishte i domosdoshëm për aplikantët, si gazetarë të akredituar, të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të informojnë publikun për punën e tyre. Gjykata Kushtetuese, e cila ka vendosur për ankesën kushtetuese të aplikantëve duket se ka të njëjtën qasje. Në rrethana të tilla, Gjykata vlerëson se e drejta për të raportuar nga galeria e Parlamentit, e cila bie në lirinë e shprehjes së ankuesve, është një “e drejtë civile” për qëllimet e nenit 6 paragrafi 1 i Konventës.²⁷

Më tej, Gjykata ka konstatuar se ato të drejta janë shkelur nga pikëpamja e nenit 6 në procedurën para Gjykatës Kushtetuese, për arsye se Gjykata Kushtetuese, si shkallë e parë dhe e vetme, ka qenë e detyruar të caktojë dhe të mbajë seancë publike gjatë vendimmarrjes mbi “të drejtat civile” të tyre: “..konstatimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masës së kontestuar janë mbështetur në çështje faktike që ajo gjykatë duhej t'i përcaktojë. Ndonëse largimi i aplikantëve nga galeria

27 Paragrafi 27 i aktgjykimit.

e Kuvendit, si i tillë, nuk ishte kontestues ndërmjet palëve, vendimi i Gjykatës Kushtetuese u bazua në fakte, të cilat u kontestuan nga aplikuesit dhe që ishin të rëndësishme për përfundimin e çështjes. Këto çështje nuk ishin as të natyrës teknike.”²⁸

Çështja kryesore që Gjykata kishte të drejtë të zgjidhte është, natyrisht, çështja e pretendimeve për shkelje të nenit 10 të Konventës, respektivisht ankesat e aplikantëve se autoritetet vendase ua kanë shkelur të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes, që është e mbrojtur me nenin 16 të Kushtetutës. Por, përpara se t'i përgjigjej kësaj pyetjeje, Gjykata fillimisht duhet të kishte vendosur për kundërshtimet e qeverisë në lidhje me mangësitë formale të pretenduara të vetë aplikimit, për arsye se qeveria ka konsideruar se aplikantët e kishin humbur statusin e tyre si “viktima” sipas Konventës, respektivisht “aplikantët nuk i kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore të brendshme efektive” me të cilat ata mund të parashtronin një aplikacion në Gjykatë.

Në lidhje me çështjen e parë për statusin e “viktimit”, Gjykata vuri në dukje se Komisioni i pavarur *ad hoc* kishte përgatitur një raport në lidhje me ngjarjet e 24 dhjetorit 2012, në të cilin, ndër të tjera, ka konstatuar se “gazetarët kanë qenë të larguar nga galeria e Kuvendit, në një mënyrë për të cilën është cenuar liria e informimit publik...”. Por, ajo gjithashtu vuri në dukje se, edhe sikur të supozohej se ajo deklaratë përbën pranim nga një autoritet shtetëror për shkelje të nenit 10 të Konventës, megjithatë një deklaratë/pranim i tillë nuk siguron dëmshpërblim që u takon viktimave në rast të shkeljes së të drejtave të garantuar me Konventë, kështu që nuk mund të konsiderohej se me vetë deklaratën/pranimin, aplikantët e kanë humbur statusin e viktimës.

Nga ana tjetër, qeveria, po ashtu, vuri në dukje se aplikantët kanë pasur më shumë rrugë ligjore përmes të cilave ata mund të siguronin mbrojtjen dhe dëmshpërblimin përpara autoriteteve vendase përpara se pretendimet ankimore të prezantohen para Gjykatës së Strasburgut. Por, Gjykata e ka refuzuar edhe këtë kundërshtim të qeverisë për arsyen se ka konsideruar se ka mjaftuar përdorimi i një mjeti juridik efektiv. Gjykata vuri në dukje se në rastin konkret, aplikantët kanë parashtruar iniciativë në Gjykatën Kushtetuese, që sipas nenit 110 paragrafi 3 të Kushtetutës ishte kompetente për zgjidhjen e rasteve në lidhje me pretendimet për shkelje të lirisë së besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes së mendimit. Gjykata Kushtetuese e ka shqyrtuar në mënyrë meritore ankesën e aplikantëve dhe e hodhi poshtë atë për arsyet e përmendura më sipër. Gjykata pranoi se ankesa kushtetuese duhet të konsiderohet një mjet efektiv për zgjidhjen e shkeljeve të lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të Konventës.

Pasi i ka hedhur poshtë dy kundërshtimet e mëparshme të qeverisë, Gjykata ka vazhduar me zgjidhjen e çështjes kyçe: “Nëse duke penguar hyrjen e aplikantëve në galeri, respektivisht nëse duke i nxjerrë me forcë nga galeria, u është shkelur liria e tyre e shprehjes e mbrojtur me Konventë dhe me Kushtetutën e vendit. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, Gjykata fillimisht është dashur të shqyrtojë: nëse një kufizim i tillë ka qenë “i parashikuar me ligj”; nëse ishte i justifikuar me ndonjë nga qëllimet legjitime në kuadër të paragrafit 2 të nenit 10, dhe, së fundi, nëse kufizimi ka qenë “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”.

28 Paragrafi 40 i aktgjykimit.

Në mënyrë që kufizimi të jetë i “parashikuar me ligj”, paragrafi i dytë i nenit 10 kërkon që masa e kontestuar të ketë bazë ligjore, jo vetëm në legjislationin e brendshëm, por edhe që kjo bazë ligjore të jetë në dispozicion të personave për të cilët është dedikuar, por edhe i parashikueshëm në lidhje me pasojat e mundshme. Prandaj, norma duhet të jetë e formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’i mundësuar qytetarit të rregullojë sjelljen e tij; respektivisht t’i parashikojë deri në masën që është e arsyeshme për rrethanat, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar. Këto pasoja nuk duhet të parashikohen me siguri absolute: “Ndonëse siguria është e dëshirueshme, ajo mund të çojë në ngurtësi të tepruar, kurse ligji duhet të jetë në gjendje të mbajë hapin me ndryshimin e rrethanave”. Në rastin konkret, sipas Gjykatës Kushtetuese, largimi i aplikantëve nga galeria e Kuvendit është bazuar në nenin 43 të Ligjit për Kuvendin dhe nenet 91-94 të Rregullores së Kuvendit. Në këtë kontekst, Gjykata arriti në përfundimin se akti i Kuvendit dhe Rregullorja e Kuvendit, të cilat kanë qenë në dispozicion të publikut, e kanë plotësuar nivelin e nevojshëm të saktësisë dhe parashikimit dhe se, në përputhje me këtë, ka mundur të konsiderohet se kufizimi ka qenë “i parashikuar me ligj”.

Së dyti, Gjykata e ka pranuar qëndrimin e qeverisë se kufizimi në këtë rast të veçantë kishte për qëllim garantimin e sigurisë publike, si dhe parandalimin e trazirave të mëdha.

Ajo që mbeti për t’u përcaktuar përfundimisht ishte nëse kufizimi ishte “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje kyçe, Gjykata së pari i ka ekspozuar parimet e përgjithshme nga praktika e saj gjyqësore, të cilat janë të zbatueshme për nenin 10 dhe lirinë e shprehjes: “Liria e shprehjes është një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet themelore për përparimin e tij dhe për vetëpërmbytjen e çdo individ. Ajo zbatohet, jo vetëm për “informacione” ose “ide” që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese, ose që lënë indiferencë, por edhe për ato “informacione” dhe “ide” që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjes së hapur pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Siç thuhet në nenin 10, kjo liri i nënshtrohet përjashtimeve, të cilat, megjithatë duhet të interpretohen në mënyrë strikte, kurse nevoja për çdo kufizim duhet të përcaktohet bindshëm. Termi “i nevojshëm”, në kuptimin e nenit 10 paragrafi 2, nënkupton ekzistencën e një “nevoje urgjente shoqërore”. Shtetet kontraktuese kanë një kufi të caktuar vlerësimi për të vlerësuar nëse ekziston një nevojë e tillë, por ajo shkon paralelisht me mbikëqyrjen evropiane, duke përfshirë, sikurse të drejtën, ashtu edhe vendimet e marra, madje edhe ato të shqiptuara nga një gjykatë e pavarur. Sipas kësaj, Gjykata është e autorizuar të marrë vendimin përfundimtar nëse “kufizimi” është në përputhje me lirinë e shprehjes të mbrojtur nga neni 10. Detyra e Gjykatës, në ushtrimin e juridiksionit të saj mbikëqyrës, nuk është të zërë vendin e autoriteteve nacionale kompetente, por t’i rishikojë, sipas nenit 10, vendimet që i kanë marrë në përputhje me fuqinë e tyre të vlerësimit. Kjo nuk do të thotë se mbikëqyrja kufizohet në përcaktimin nëse shteti i paditur e ka ushtruar diskrecionin e tij në mënyrë të arsyeshme, me kujdes dhe me vullnet të mirë; ajo që duhet të bëjë Gjykata është të shqyrtojë kufizimin që është objekt i pretendimeve ankimore në kontekstin e çështjes si tërësi dhe të përcaktojë nëse ai ishte “proporcional me qëllimin legjitim” dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet vendase për ta justifikuar atë janë “relevante dhe të mjaftueshme... Duke vepruar kështu, Gjykata duhet të bindet që autoritetet vendase

kanë zbatuar standarde që kanë qenë në përputhje me parimet e mishëruara në nenin 10 dhe, për më tepër, se janë mbështetur në një vlerësim të pranueshëm të fakteve relevante.²⁹

Në rastin konkret, gjatë vlerësimit nëse largimi i aplikantëve nga galeria nga Shërbimi parlamentar i sigurimit ishte i nevojshëm apo jo, Gjykata i ka marrë parasysh interesat konfliktuale që duheshin balancuar dhe për të cilat kishte një interes publik, përkatësisht: nga njëra anë mënyra e funksionimit të shërbimit të sigurisë dhe ruajtja e rendit në Kuvend dhe, nga ana tjetër, interesi i publikut për marrjen e informacioneve në lidhje me çështje me interes të përgjithshëm. Ajo që është dashur të bëhet gjatë vlerësimit të tillë është të përcaktohet nëse kufizimi i kontestuar, i parë në tërësi, ka qenë i mbështetur me arsye relevante dhe të mjaftueshme të përfshira në vendimet e brendshme, si dhe nëse ishte proporcional në raport me objektivat legjitime. Në të njëjtën kohë, në vlerësim ishte domethënëse nëse largimi i aplikantëve është bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të fakteve nga ana e institucioneve, respektivisht nëse aplikantët kanë qenë në gjendje të raportojnë për incidentet në Kuvend. Përfundimisht, Gjykata e ka marrë parasysh edhe sjelljen e aplikantëve gjatë gjithë incidentit.

Gjykata ka vërejtur se ngjarjet në sallën e Kuvendit janë provokuar nga një grup deputetësh. Aplikantët ishin gjatë gjithë kohës në galeri, e cila ndodhej sipër sallës plenare. Gjatë trazirave në sallë, aplikantët kanë qenë vëzhgues pasivë, të cilët vetëm e kanë kryer profesionin e tyre gazetaresk dhe i kanë vëzhguar ngjarjet. Prandaj, ata as nuk përbënin kërcënim për sigurinë publike dhe as nuk përbënin kërcënim për ruajtjen e rendit në sallë. Gjykata, gjithashtu, ka vërejtur se largimi i aplikantëve nga galeria nuk ka qenë për shkak të refuzimit të tyre për t'iu bindur urdhrave të shërbimit të sigurisë, por për shkak të vlerësimit të rrezikut të bërë nga i njëjti shërbim që prezenca e vazhdueshme e aplikantëve në galeri përbënte një kërcënim për jetën dhe integritetin e tyre fizik. Gjykata nuk ka gjetur indicie se trazirat në sallë mund të kërcënonin jetën dhe integritetin fizik të gazetarëve në galeri. Praktikisht, i vetmi element i rëndësishëm mbi të cilin Gjykata Kushtetuese e ka bazuar konstatimin e saj se aplikantët ishin të pasigurt ishte pretendimi se “gjësende të ndryshme u hodhën nëpër sallë - disa në drejtim të galerisë”. Megjithatë, për faktin se nuk u dha asnjë shpjegim i mëtejshëm për llojin dhe numrin e gjësendeve të hedhura dhe nëse ndonjë nga ato gjësende kishte përfunduar në galeri, Gjykata nuk e pranoi këtë argument si të mjaftueshëm - gjë që në vetvete do të kishte justifikuar kufizimin.

Në fund, Gjykata ka vërejtur se pavarësisht faktit që gazetarët mundën të ndiqnin drejtpërdrejt ngjarjet, përmes kanalit parlamentar, respektivisht nëpërmjet video-lidhjes, përjashtimi i tyre: “ka shkaktuar pasoja negative të menjëhershme, që i kanë penguar aplikantët të marrin informacione të drejtpërdrejta dhe të dorës së parë të bazuara në vëzhgimet e tyre personale, për ngjarjet e ndodhura në sallë, e për rrjedhojë edhe për mënyrën se si autoritetet janë ballafaquar me to”. Sipas Gjykatës, këta ishin elemente të rëndësishëm në kontekstin e ushtrimit të profesionit gazetaresk – elemente këto nga të cilët publiku nuk është dashur të privohet.

Prandaj, Gjykata u shpreh se qeveria kishte dështuar të dëshmonte se largimi i aplikantëve nga galeria ishte i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, respektivisht se ajo e ka përmbushur kushtin e “nevo-

29 Paragrafi 71 i aktgjykimit.

jës urgjente shoqërore”. Arsyet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese ishin të rëndësishme, por, në rrethanat e të gjithë rastit, ato nuk mund të konsideroheshin edhe si të mjaftueshme për të justifikuar largimin e aplikantëve nga galeria dhe, rrjedhimisht, edhe kufizimin e të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara nga neni 10 i Konventës.

Koment

Gjykata në disa raste ka nënvizuar se grumbullimi i informacioneve, si një hap përgatitor në ushtrimin e profesionit gazetaresk ka një rëndësi thelbësore për lirinë e shtypit dhe si e tillë, mbrohet njëloj nga neni 10 i Konventës. Prandaj, çdo hap përgatitor i ndërmarrë përpara publikimit të informacionit të caktuar, duke përfshirë të gjitha aktivitetet kërkimore dhe ekzaminuese tërheq vëmendje të veçantë gjatë vendimmarrjes së Gjykatës, mbi të gjitha për shkak të rrezikut të madh potencial që mund të shkaktohet nga kufizimet e ndryshme në këto aktivitetet: “... qasja në informacionet e rastit në fjalë ka qenë elementi thelbësor i ushtrimit të së drejtës së aplikantët për lirinë e shprehjes, respektivisht kjo ka qenë pjesë e mbledhjes legjitime të informacioneve me interes publik, me synimin për t’i transmetuar ato informacione te publiku dhe duke kontribuar kështu në debatin e hapur publik”.³⁰

Gjykata rithekson shpesh se pengesat e krijuara qëllimisht, të cilat synojnë të pengojnë aksesin në informacione që shkaktojnë interes publik, mundet lehtësisht t’i dekurajojnë ata që punojnë në media ose në fusha të ngjashme që të mos merren fare me punë të tilla: ...dhe si rezultat i kësaj, ata (gazetarët) mund të mos jenë më në gjendje të luajnë rolin e tyre jetik si “kujdestarë publikë”, që do të thotë se përpjekja e tyre për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme mund të rezultojë negativisht³¹

Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për rastet në të cilat gazetarët kanë qenë të penguar të kenë akses në një vend të caktuar nga ku ata mund të raportojnë nga dora e parë pas “vëzhgimit personal”, Gjykata ka theksuar se një pengesë e tillë paraqet “ndërhyrje” në lirinë e shprehjes. I tillë është, për shembull, rasti i *Gsell v. Switzerland* në të cilën aplikantit i është ndaluar hyrja në Davos, Zvicër, gjatë mbajtjes së Forumit Ekonomik Botëror, për shkak të ekzistimit të një ndalesë të përgjithshme për hyrjen e personave të paakredituar me qëllim të parandalimit të protestave dhe incidenteve të padëshiruara. Në këtë rast, Gjykata ka vërejtur se qëllimi i aplikantit ka qenë të udhëtojë Davos për të shkruar një artikull gazetaresk për një temë të caktuar. Prandaj, refuzimi për t’iu lejuar atij hyrja në Davos (me arsyetimin se kjo nuk ka qenë e “e parashikuar me ligj” për qëllimet e nenit 10 paragrafi 2 i Konventës) përbënte shkelje të të drejtave të tij të garantuara nga neni 10 i Konventës.³²

Praktika e Gjykatës është në të njëjtën linjë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në parlament, respektivisht në punën e organeve më të larta legjislative, ku lirisht mund të konkludohet se liria mbrohet edhe në një nivel më të lartë. Në fakt, sipas Gjykatës, parlamenti është i vetmi forum për debat në një shoqëri demokratike, që ka rëndësi fundamentale për demokracinë. Çfarëdo pengimi apo largimi i gazetarëve nga skena e ngjarjeve në parlament: “rezulton me efekte negative të drejtpërdrejta, që i pengojnë gaze-

30 *Magyar Helsinki Bizottsag v. Hungary*, no.18030/11, § 131, 08 November 2016.

31 *Shapovalov v. Ukraine*, no.45835/05, § 68, 31 July 2012.

32 Për më shumë detale, shih *Gsell v. Switzerland*, no. 12675/05, 8 October 2009.

tarët të marrin informacione të dorës së parë dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë, bazuar në praninë e tyre personale në ngjarjet që ndodhin në sallë, për arsye që elementë të tillë janë domethënës në ushtrimin e profesionit të tyre gazetaresk, nga i cili publiku nuk duhet të privohet”.³³

Për këto arsye, autoritetet nacionale duhet të ofrojnë siguri të gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik në masën e nevojshme që ata të jenë në gjendje të përmbushin detyrën e tyre profesionale për të raportuar për ngjarje me interes të jashtëzakonshëm publik.

Ekzekutimi i aktgjykimit

Ekzekutimi i këtij rasti gjyqësor është mbyllur plotësisht me miratimin e një rezolute përfundimtare³⁴ nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, i cili, sipas nenit 46 paragrafi 2 i KEDNJ, ka autoritetin të mbikëqyrë ekzekutimin e aktgjyqimeve të GJEDNJ-së. Me këtë rezolutë përshëndeten masat e ndërmarra të veçanta dhe të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit, të përcaktuara tashmë në Raportin e veprimit të parashtruar dorëzuar nga shteti.³⁵

Më konkretisht, lidhur me masat e veçanta, shteti ka theksuar se krahas pagesës së kompensimit të drejtë në shumën prej 5.000 euro që i është dhënë secilit prej aplikantëve veç e veç, në përputhje me paragrafin 90 të aktgjykimit të GJEDNJ, aplikantët kanë pasur edhe mundësinë juridike për të kërkuar dëmshpërblim të dëmit sipas nenit 365 të Ligjit për marrëdhënie obligative. Ajo, po ashtu, ka konstatuar se duke marrë parasysh natyrën e shkeljeve të konstatuara, nuk ka pasur mundësi të ndërmerren çfarëdo masa të tjera, të cilat do t'i kishin kthyer aplikantët në të njëjtin pozicion në të cilin kanë qenë para shkeljeve.³⁶

Masat e përgjithshme kanë qenë të lidhura kryesisht me ndryshimet në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, si mjet për të parandaluar shkelje të ngjashme të nenit 6 të Konventës në të ardhmen.³⁷ Nga pikëpamja e nenit 10, përmenden një sërë aktiviteteve edukative, si dhe masat e ndërmarra për përkthimin dhe shpërndarjen e aktgjykimit. Megjithatë, shteti i ka kushtuar vëmendje të veçantë avancimit të bashkëpunimit me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: SHGM) përmes nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet SHGM-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sipas shtetit, ky veprim e shpreh qartë vullnetin politik të Ministrisë për të bashkëpunuar me gazetarët dhe për të përforcuar klimën e përgjegjësive për dhunën e kryer ndaj gazetarëve dhe do të mundësojë përgatitjen e një protokollit për raportim për ngjarjet me rrezikshmëri të lartë, pa cenuar sigurinë e gazetarëve.³⁸

33 Paragrafi 84 i Aktgjykimit

34 Council of Europe, Resolution CM/ResDH(2018)216, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights, Selmani and Others against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 7 June 2018 at the 1318th meeting of the Ministers’ Deputies), i aksesueshën në: [https://hudoc.exec.coe.int/eng#\(f%22fulltext%22:f%22Selmani%22\)%22EXECLIdentifier%22:f%222001-184019%22\)%22EXECLDocumentTypeCollection%22:f%22res%22\)%22EXECLanguage%22:f%22ENG%22}](https://hudoc.exec.coe.int/eng#(f%22fulltext%22:f%22Selmani%22)%22EXECLIdentifier%22:f%222001-184019%22)%22EXECLDocumentTypeCollection%22:f%22res%22)%22EXECLanguage%22:f%22ENG%22}) nga dt. 19.10.2022.

35 1318th meeting (June 2018) (DH) - Action report (03/05/2018) - Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the case of Selmani and Others v. the former Yugoslav Republic of Macedonia (Application No. 67259/14), DH-DD(2018)454, i qasshëm në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016807c810c>, nga dt. 19.10.2022.

36 Paragrafët 5-7 nga Raporti i Veprimit, i përmendur më sipër.

37 Paragrafët 9-13 nga Raporti i Veprimit.

38 Paragrafi 24 nga Raporti i Veprimit.

Masat e përmendura kanë qenë të pranuar nga Komiteti i Ministrave, si të mjaftueshme për mbylljen e shqyrtimit të mëtejshëm të këtij rasti.

2.2. MAKRADULI³⁹

Fakte mbi rastin

Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i shqiptuar në këtë rast rezultoi nga dy aplikimet e veçanta të parashtruara nga i njëjti aplikant, z. Jani Makraduli, më 30 shtator 2011, respektivisht më 1 prill 2013.

Më konkretisht, aplikimi i parë i referohej procedurës penale të ngritur kundër aplikantit në lidhje me pretendimet e tij se z. S.M., kushëri i kryeministrit të atëhershëm, i cili në atë kohë ishte anëtar i lartë i partisë politike në pushtet VMRO-DPMNE dhe drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit (në tekstin e mëtejshëm: “Drejtori”, “DSK”) e ka shfrytëzuar pozitën e tij dhe e ka keqpërdorur pajisjen e policisë për përgjim, me qëllim që të ushtrojë ndikim në tregtimin e Bursës së Maqedonisë, me qëllim që të marrë informacione me kohë, që do t’i siguronin fitime të sigurta.

Në të njëjtën kohë, aplikanti ka pyetur nëse z. S.M. ka fituar qindra mijëra euro në këtë mënyrë, duke shprehur dyshime në bazë të letrës anketuese që e ka dorëzuar z. S.M., në të cilën është shënuar se ai zotëronte aksione në vlerë prej 300.000 euro. Më tej ai ka pyetur nëse ndonjë pjesë e asaj prone, z. S.M. e ka fituar atë gjatë nëntë muajve derisa ka qenë në detyrë pa dorëzuar fletë anketuese dhe nëse kjo ka qenë arsyeja pse nuk është dorëzuar asnjë fletë anketuese gjatë nëntë muajve të parë të mandatit të tij.⁴⁰

Aplikacioni i dytë, nga ana tjetër, ka përfshirë një procedurë tjetër penale kundër aplikantit sa i përket deklaratave të tij lidhur me veprimet kundërligjore të supozuara gjatë shitjes publike të tokës ndërtimore shtetërore në qendër të Shkupit, në të cilën ka qenë i planifikuar ndërtimi i një hoteli, nga një kompani e afërt me kushëririn e kryeministrit të atëhershëm.⁴¹

Në të dyja rastet, deklaratat e kontestuara janë bërë publike gjatë konferencave të ndara për shtyp të mbajtura në ambientet e partisë LSDM më 14 dhjetor 2007 (të transmetuara në TV ditarin qendror të kanalit televiziv më të njohur nacional të atëhershëm A1), respektivisht më 9 shtator 2007 (po ashtu të transmetuara në lajmet televizive).⁴² Të dyja procedimet penale kanë filluar pas kallëzimit penal privat të ngritur nga z. S.M.

39 *Makraduli v. the former Yugoslav Republic of Macedonia*, nos. 64659/11 and 24133/13, 19 July 2018. Lidhur me këtë rast, shih po ashtu, Delovski, V. (2019), Liria e shprehjes politike në shoqëritë demokratike në dritën e aktgjykimit “Makraduli kundër Republikës së Maqedonisë”, qasur në: <https://justiceobservers.org/article/68860/63647/187>, nga dt. 07.10.2022.

40 Sipas paragrafëve 7 dhe 11 të aktgjykimit.

41 Paragrafi 20 i aktgjykimit.

42 Në rastin e dytë, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se rrethana që paditësi privat nuk ka qenë i emërtuar, respektivisht nuk ka qenë i përmendur me emër dhe mbiemër nga aplikantit, ka qenë jorelevante për veprën konkrete penale, duke pasur parasysh se shumë qartësisht dhe pa mëdyshje ka mundur të njihet personaliteti z. SM, i cili ka qenë i emërtuar me mbiemrin e tij edhe nga prezantuesi i TV lajmeve – ku është raportuar për konferencën për shtyp të mbajtur (paragrafi 26 i aktgjykimit të GJEDNJ).

Si pasojë e procedurës penale që u zhvillua kundër tij, në rastin e parë aplikanti u dënua për shpifje në përputhje me nenin 172 të Kodit Penal të Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Kodi Penal), që ka qenë në fuqi në atë kohë, dhe i ishte shqiptuar gjobë në të holla në shumë prej 1500 euro, e cila ka mundur të shndërrohet në burg prej 75 ditësh, nëse aplikanti nuk e paguan shumën prej 75 gjobave ditore prej 20 euro. Në rastin e dytë, megjithatë, atij i është shqiptuar 1000 euro gjobë, me mundësi ndryshimi të dënimit me burg prej njëqind ditësh, nëse nuk e paguan atë gjobë.⁴³

Megjithatë, bazuar në ndryshimet ligjore që kanë pasuar me miratimin dhe hyrjen në fuqi të LPCOSH, më 12 shkurt 2013 gjykata e ka ndaluar ekzekutimin e sanksioneve të shqiptuara në të dyja proceset, kështu që aplikanti ka paguar vetëm shpenzimet gjyqësore, por jo edhe gjobat e shqiptuara në të holla.⁴⁴

Pas përfundimit të plotfuqishëm të procedurës penale, aplikanti është përpjekur para Gjykatës Kushtetuese të adresojë çështjen e shkeljes së lirisë së tij të shprehjes duke parashtruar dy kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave sipas nenit 110 alinesë 3 të Kushtetutës.

Në kërkesën e parë të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, ai ka paraqitur argument se është dënuar për pyetje që i ka parashtruar në një konferencë për shtyp të mbajtur në emër të partisë së tij politike. Kjo pyetje është bazuar në informacione të dërguara në partinë e tij, për shkak të dyshimit për parregullsi në punën e një bartësi të funksionit publik dhe ka pasur për qëllim të nxiste debat publik nëse zyrtari ka qenë i ndërgjegjshëm gjatë kryerjes së funksionit.⁴⁵ Nga ana tjetër, në kërkesën e dytë, aplikanti ka pohuar se, si përfaqësues i një partie politike, atij i është kërkuar të paraqesë informacione që i janë demonstruar, ku ai nuk ka prezantuar pohim faktik, por ka ngritur një çështje në lidhje me pretendimet për korrupsion.⁴⁶

Të dyja kërkesat e aplikantit janë hedhur poshtë me vendime adekuate të Gjykatës Kushtetuese⁴⁷ dhe gjatë kësaj ajo (Gjykata) ka dhënë justifikim të ngjashëm se... mënyra se si parashtruesi i kërkesës ka shprehur opinionin e tij në publik, në lidhje me kryerjen e detyrave publike nga një bartës i funksionit publik (në formë pyetjeje, si anëtar i një partie politike opozitare, nga foltorja e partisë politike, pasojat që kanë ardhur nga paraqitja e tij publike...), pa u përpjekur për të dëshmuar të vërtetën e pyetjes apo deklaratës, të analizuar në tërësinë e tyre, paraqet veprim, i cili vetëm në mënyrë të dukshme hyn në sferën e lirisë së besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit por, në thelb, e cenon nderin dhe reputacionin e qytetarit që aktualisht kryen funksionin publik në fjalë dhe i cenon ato vlera. Rrjedhimisht, deklarata në fjalë i ka humbur atributet e asaj lirie (të mendimit dhe të shprehjes publike të mendimit) dhe paraqet keqpërdorim (të asaj lirie).⁴⁸

43 Për më tepër, në bazë të rezultateve nga procedura e parë penale, z. S.M. ka iniciuar edhe procedurë kontestimore në të cilën kërkesa e tij paditëse për dëmshpërblim të dëmit jomaterial e njëjta i është miratuar, duke i kompensuar 550.000 denarë (paragrafi 19 i aktgjykimit).

44 Paragrafët 15 dhe 28 të aktgjykimit.

45 Paragrafi 17 i aktgjykimit.

46 Paragrafi 29 i aktgjykimit.

47 Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 146/2010, i dt. 23 shkurt 2011 (<http://ustavensud.mk/?p=10448>) dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 155/2011, i dt. 12 shtator 2012 (<http://ustavensud.mk/?p=10800>), prej dt. 10.10.2022.

48 Paragrafët 18 dhe 30 të aktgjykimit.

Gjetje të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Me këtë aktgjykim, GJEDNJ ka hyrë në një diskutim dhe vendimmarrje meritore për pretendimet ankimore të theksuara në këto aplikacione, të cilat i janë referuar asaj se aktgjykimet ndëshkuese penale për shpifje në të dyja rastet kanë rezultuar me cenimin e lirisë së shprehjes së kërkuesit.

Aktgjykimi jep një pasqyrë të standardeve dhe parimeve të përgjithshme të vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, lidhur me çështjen e kufijve të lirisë së shprehjes politike dhe fjalës politike, në përputhje me nenin 10 të Konventës. Për më tepër, ato janë përpunuar dhe aplikuar me mjeshtëri dhe zbatohen në rrethanat e këtij rasti konkret.

Duke qenë se ishte e pakontestueshme midis aplikantit dhe qeverisë, si dy palë kundërshtarë në proces, GJEDNJ-ja fillimisht konstaton se këtu bëhet fjalë për ndërhyrje në të drejtën e aplikantit për lirinë e shprehjes, e cila është parashikuar me ligj ose më konkretisht me nenin 172. të KP-së, ku kjo ka shërbyer për mbrojtjen e reputacionit të z. S.M., i cili është nënvizuar si i vetmi qëllim legjitim edhe nga gjykatat vendase.⁴⁹ Kështu, Gjykata e ka konfirmuar vlerësimin që tashmë është bërë nga gjykatat kompetente të vendit në kuadër të fushës së tyre të vlerësimit të lirë (*margin of appreciation*), në aspektin e ligjshmërisë dhe ekzistimit të një qëllimi legjitim që do të arsyetonte ndërhyrjen. Më pas, Gjykata do të nisë një studim të thelluar të domosdoshmërisë së një ndërhyrjeje të tillë në një shoqëri demokratike, si element i tretë i testit të proporcionalitetit që zakonisht e zbaton në këtë lloj rastesh gjyqësore.

Duke u nisur nga parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën e saj, Gjykata ripohon se, sipas nenit 10 paragrafi 2 i Konventës, ka shumë pak hapësirë për kufizime të fjalës politike apo debatit për çështje me interes publik. Prandaj, zakonisht përcaktohet një shkallë e lartë e mbrojtjes së lirisë së shprehjes, ku shtetet kanë një kufi veçanërisht të ngushtë vlerësimi në raste të tilla, kur vërejtjet kanë të bëjnë me një çështje me interes publik.⁵⁰

Më tej, GJEDNJ-ja në analizën e saj i referohet dallimit ndërmjet pohimeve faktike dhe gjykimeve vlerësuese, që është vendosur në praktikën e saj gjyqësore. Në kontekstin e fjalës politike, Gjykata thekson se, megjithëse saktësia e gjykimeve vlerësuese, në parim, nuk është e përshtatshme për t'u provuar, nëse ka pasur "bazë faktike" të mjaftueshme mbi të cilën ato do të bazoheshin, kjo nuk do të kishte vlejtur në rastet kur deklaratat vlerësuese janë bërë gjatë një debati të gjallë politik.

Kështu, deputetët e zgjedhur duhet të gëzojnë liri më të madhe për të kritikuar procedurat qeveritare, madje edhe nëse gjykimet e tyre vlerësuese në lidhje me çështjet e interesit publik nuk kanë një bazë të qartë faktike.⁵¹

49 Paragrafi 58 i aktgjykimit.

50 Paragrafi 61 i aktgjykimit.

51 Paragrafi 62 i aktgjykimit. Por, gjatë kësaj, rekomandohet *mutatis mutandis* e *Lombardo and Others v. Malta*, no. 7333/06, § 60, 24 April 2007.

Po ashtu, GJEDNJ-ja e adreson edhe çështjen e natyrës dhe peshën së sanksioneve të shqiptuara, duke theksuar se edhe natyra relativisht modeste e gjobave në të holla nuk e mohon në vetvete rrezikun e një “efekti frenues” në ushtrimin e mëtejshëm të lirisë së shprehjes. Në këtë kuptim, Gjykata e thekson nevojën që shtetet të tregojnë vetëpërmbytje në drejtim të teprimit me procedura penale.⁵²

Gjykata, kur i zbaton parimet e saj për faktet e kësaj çështjeje, merr në konsideratë veçanërisht aspektet e mëposhtme relevante:

- 1. pozicionin e paditësit dhe aplikantit që ka pasur cilësinë e të paditurit në procedurat e brendshme,**
- 2. objektin e pretendimeve të aplikantit, si dhe**
- 3. kualifikimin e tyre nga gjykatat vendase dhe qasja e gjykatave në justifikimin e ndërhyrjes.⁵³**

Në lidhje me statusin e aplikantit, Gjykata e nënvizon faktin e pakontestueshëm se deklaratat e aplikantit janë dhënë në cilësinë e nënkryetarit të partisë opozitare të atëhershme LSDM, në konferencat për shtyp të mbajtura në selinë e partisë së tij, në emër të partisë së tij dhe në kontekst politik. Për më tepër, theksohet se aplikanti ka qenë deputet i Kuvendit të Maqedonisë, i cili si përfaqësues i zgjedhur i qytetarëve i jep atij një shkallë edhe më të lartë të mbrojtjes së fjalës politike, e cila mund të kufizohet vetëm nëse ka arsye shumë të forta për atë. Duke vepruar kështu, GJEDNJ-ja vë në dukje se, ndryshe nga gjykatat e rregullta, vetëm Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se aplikanti ka qenë edhe deputet dhe si i tillë duhej të gëzonte mbrojtje më të madhe, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se përfaqësuesit e zgjedhur janë ata që e përfaqësojnë elektoratin, u kushtojnë vëmendje preokupimeve të tij dhe i mbrojnë interesat e elektoratit.⁵⁴ Megjithatë, kjo gjykatë ka harruar të tregojë se, me vetë faktin që deklaratat e tij i ka prezantuar në ambientet e partisë së tij politike dhe jo në Parlament, ai ka zgjedhur të mos përfitonte nga niveli më i lartë i mbrojtjes që do të kishte nëse do të ishte thirrur në imunitetin parlamentar.⁵⁵

Duke marrë parasysh statusin e paditësit, z. S.M., i cili ishte bartës i rangut të lartë të një posti shtetëror dhe ishte përgjegjës për punën e tij para Qeverisë, GJEDNJ-ja vëren se kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjera për zyrtarët shtetërorë sesa për individët privatë. Prandaj, ata duhet të demonstrojnë një shkallë më të madhe tolerance ndaj kritikave, ku veprimet ose mosveprimet e tyre mund t'i nënshtrohen një shqyrtimi të menjëhershëm, jo vetëm nga autoritetet legislative dhe gjyqësore, por edhe nga opinioni publik. Gjithashtu, duke pasur parasysh se z. S.M. ishte edhe politikan, ai në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije e ka ekspozuar veten ndaj kontrollit të menjëhershëm të çdo fjale dhe veprimi të tij, si nga gazetarët ashtu edhe nga publiku i gjerë, dhe për këtë arsye do të duhej të kishte treguar një shkallë më të

52 Paragrafi 63 i aktgjykimit.

53 Paragrafi 64 i aktgjykimit. Këto elemente të analizës janë marrë nga aktgjykimit në rastin *Lombardo and Others v. Malta*, no. 7333/06, § 52, 24 prill 2007.

54 Paragrafët 65-67 të aktgjykimit

55 Paragrafi 82 i aktgjykimit.

lartë tolerance. Për rrjedhojë, GJEDNJ-ja arrin në përfundimin se gjykatat vendase e kanë pasur parasysh ekskluzivisht statusin e z. S.M. si zyrtar civil, por ato nuk kanë pranuar që liria e shprehjes i nënshtrohej kufijve më të gjerë të kritikës së pranueshme dhe as nuk e kanë marrë parasysh faktin që ai ishte edhe politikan.⁵⁶

Lidhur me përmbajtjen, respektivisht lëndën e deklaramëve kontestuese, Gjykata e konsideron problematike trajtimin e tyre, kualifikimin si pohime faktike, në vend të gjykimeve vlerësuese, edhe atë si nga gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe nga Gjykata e Apelit, sepse ato u janë referuar pretendimeve për veprim kundërligjor gjatë kryerjes së detyrës zyrtare të z. S.M. dhe kanë trajtuar çështje me interes publik. Gjykata njëjtë e kritikon edhe qasjen identike, sa i përket kërkesës për dëshminë e deklaratave të aplikantit që është zbatuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, pavarësisht faktit se kjo gjykatë ka vlerësuar në mënyrë të drejtë se bëhet fjalë për “mendime” e jo për pohime faktike.⁵⁷ GJEDNJ-ja e ka marrë në konsideratë edhe formën dhe kontekstin në të cilin deklaratat e aplikantit janë transmetuar në publik.⁵⁸ Sa i përket procedurës së parë penale, Gjykata vlerëson se dorëzimi me vonesë i fletës anketuese nga z. S.M., si dhe thashethemet e pranishme në publik në lidhje me këtë, përfaqësonin elemente që tregonin për ekzistencën e një baze faktike të mjaftueshme për pretendimin e aplikantit – vërtetësinë e së cilës ai nuk kishte asnjë detyrim ta provonte.⁵⁹ Megjithatë, në lidhje me procedurën e dytë penale, Gjykata vëren se deklaratat publike të aplikantit kanë pasur për qëllim të paraqisnin gjetjet e hulumtimit të kryer nga partia e tij politike dhe, megjithëse ato mund të konsideroheshin sarkastike, ato nuk kanë përmbajtur shprehje qartësisht ofenduese për shkak të të cilave do të shkonte përtej ekzagjerimit ose provokimit të pranueshëm.⁶⁰

Si rrjedhojë, GJEDNJ-ja konkludon se deklaratat e dhëna kanë qenë koment fillestar për çështje me interes legjitim publik, duke përfshirë edhe konfliktin e interesave që z. S.M. do të mund ta kishte si bartës i funksionit të lartë publik gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve të caktuara afariste. Ata prekën nevojën për transparencë dhe parandalimin e keqpërdorimit të pozitës nga funksionarë publikë dhe kanë synuar përforcimin e integritetit publik dhe ruajtjen e besimit të publikut në institucionet publike.⁶¹

Gjatë konstatimit të shkeljes së nenit 10, GJEDNJ-ja vlerëson gjithashtu se, edhe pse gjjobat e shqiptuara nuk kanë mundur të paguhen për shkak të ndryshimeve ligjore që e dekriminalizuan shpifjen, dënimi i aplikantit ka pasur një veprim frenues (*chilling effect*) ndaj debatit politik për çështje të rëndësishme me interes të përgjithshëm, të cilat do të kishin qenë thelbësore për funksionimin e demokracisë.⁶²

Në përgjithësi, Gjykata konstaton se standardet e aplikuara në procedurat kontestimore ishin të papajtueshme me parimet e mishëruara në nenin 10 të Konventës dhe gjykatat vendase nuk ia dolën të arrinin

56 Paragrafët 68-73 të aktgjykimit

57 Paragrafi 75 i aktgjykimit.

58 Paragrafi 77 i aktgjykimit.

59 Paragrafët 78 dhe 80 të aktgjykimit.

60 Paragrafi 79 i aktgjykimit.

61 Paragrafi 80 i aktgjykimit.

62 Paragrafi 83 i aktgjykimit.

një ekuilibër të drejtë midis interesave kundërshtuese që janë cenuar.⁶³ Prandaj, ndërhyrja ka qenë në disproporcion me qëllimin legjitim të vendosur dhe nuk ka qenë e “domosdoshme në një shoqëri demokratike” sipas kuptimit të nenit 10 paragrafi 2.⁶⁴

Përfundimisht, GJEDNJ-ja i ka akorduar aplikantit 1500 euro si dëmshpërblim për dëmin jomaterial, si dhe 1020 euro për shpenzimet dhe harxhimet tjera që kanë ndodhur në procedurën në fjalë..

Koment

Ky aktgjykim është shumë relevant, sepse ngre çështje të rëndësishme në lidhje me ushtrimin e lirisë së shprehjes politike në kontekstin specifik politik dhe juridik të vendit tonë, në të cilin filloi një praktikë e ngritjes së ndërsjellë të procedurave penale dhe kontesteve ndërmjet politikanëve që u përkasin opsioneve të ndryshme politike, e që ndodhnin me rastin e çështjeve që ishin ngritur në kuadër të debatit politik publik.

Në të njëjtën kohë, ky është i vetmi aktgjykim i GJEDNJ-së, krahas atij të shqiptuar në rastin *Gelevski*, i cili i referohet ndërhyrjes në lirinë e shprehjes të aplikantëve përmes ngritjes së procedurës penale. Kjo duke pasur parasysh faktin se pretendimet ankimore të aplikantëve të paraqitur në këto dy raste (*Makraduli dhe Gelevski*) – në aspektin kohor përfshijnë periudhën në të cilën shpifja dhe ofendimi ishin ende akte të inkriminuara, të cilat u përfshinë si vepra penale në kapitullin e tetëmbëdhjetë “Vepra penale kundër nderit dhe reputacion” nga Kodi Penal.⁶⁵ Prandaj, edhe në rastin *Makraduli*, GJEDNJ-ja e theksoi nevojën për t’u përmbajtur nga teprimi i procedurave penale, veçanërisht nëse mjetet e tjera ishin në dispozicion për t’iu përgjigjur sulmeve dhe kritikave të pajustificuara nga kundërshtarët.⁶⁶

Në këtë aktgjykim, Gjykata e Strasburgut mban një qëndrim kritik në lidhje me aspekte të ndryshme që lidhen me qasjen dhe sjelljen e gjykatave vendase në procedura penale të zhvilluara kundër aplikantit. Në fakt, nga rezultati i tyre dhe nga konkluzionet e gjykatave vendase rezulton se në vendimarrjen e tyre fillimisht janë udhëhequr nga nevoja për të mbrojtur të drejtat personale, respektivisht reputacionin e z. S.M. si bartës i postit publik, të cilit i është dhënë përparësi në procesin e balancimit kundër mbrojtjes së lirisë së shprehjes politike.

Edhe pse GJEDNJ-ja e përmend vetëm dekriminalizimin e shpifjes si një veprim legjislativ, që i paraprin këtij aktgjykimi⁶⁷, në mënyrë implicite u dërgon mesazh gjykatave vendase në lidhje me standardet që ato duhet të respektojnë në ndarjen e drejtësisë kur e zbatojnë LPCOSH-së, veçanërisht kur vendosin për ndërhyrje në realizimin e lirisë së shprehjes politike, në drejtim të adresimit të çështjeve me interes publik. Tek kjo, në fakt, orientojnë edhe zgjidhjet adekuate të LPCOSH-së, të cilat parashikojnë zbatimin e detyrueshëm të

63 Paragrafi 84 i aktgjykimit.

64 Paragrafi 85 i aktgjykimit.

65 Kodi penal (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 87/2007, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/2011 dhe 185/2011)

66 Paragrafi 72 i aktgjykimit.

67 Paragrafët 36 dhe 37 të aktgjykimit.

praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 2 paragrafi 2), si dhe preferencat e KEDNJ-së dhe mendimet e GJEDNJ-së të përfshira në aktgjykimet e saj kur ka një zbrazëturë juridike ose konflikt të dispozitave të këtij ligji me KEDNJ-në (neni 3).

Në fakt, përmes këtij aktgjykimi të GJEDNJ-së, gjykatësit e Maqedonisë duhet të sensibilizohen për rolin e tyre në ringjalljen e demokracisë, sundimin e ligjit dhe respektimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore. Prandaj, edhe pse ky aktgjykim merret me fjalimin e politikanëve, në fakt ka një kuptim më të gjerë për sigurimin e një mjedisi për raportim kritik ndaj publikut nga mediat në lidhje me mënyrën se si kryhen funksionet publike, e cila, nga ana tjetër, duhet të kontribuojë në rritjen e transparencës. parandalimin në kohë të çdo abuzimi të autorizimit zyrtar, si dhe në luftën efektive kundër korrupsionit. Në këtë kontekst, gjyqtarët duhet të kenë një ndërgjegjësim për rolet e aktorëve të ndryshëm në jetën shoqërore dhe politike, të bëjnë një dallim të qartë midis deklaratave faktike dhe gjykimeve vlerësuese, të njohin atë që përbën interes publik dhe të parandalojnë çdo pengim të debatit për çështje që janë me rëndësi për publikun, pavarësisht nëse ato janë ngritur dhe për to të diskutohen ekskluzivisht brenda arenës politike apo jashtë saj.

Njëkohësisht, përveç rendit juridik të Maqedonisë, ky aktgjykim, padyshim, ofron edhe udhëzime të caktuara edhe për sistemet e tjera juridike, veçanërisht në ato vende në të cilat “politikanët dhe deputetët e opozitës mund të jenë në shënjestër të veçantë të autoriteteve”, për këtë arsye duhet të vendosen mekanizma vendorë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e tyre.⁶⁸ Për më tepër, Mendimi i ndarë i këtij aktgjykimi thekson se demokracia në vetvete nënkupton që garancitë e larta për lirinë e fjalës politike të vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ duhet vlejë jo vetëm për elitat politike – të cilave në parim u njihen të drejta më të gjera. Por edhe për “njerëzit e zakonshëm”.⁶⁹ Në fund të fundit, “në një demokraci kushtetuese, çdokush mund të paraqesë çështje me interes të përgjithshëm për debat publik...”, që përbën edhe...rolin e çdo qytetari”.⁷⁰

Ekzekutimi i aktgjykimit

Implementimi i këtij aktgjykimi ka përfunduar me miratimin e Rezolutës finale⁷¹ nga ana e Komitetit të Ministrave.

Nga këqyrja e Raportit të veprimit të parashtruar nga shteti,⁷² i cili ka qenë bazë për mbylljen e ekzekutimit të këtij rasti, është evidente se ndër masat e përgjithshme për ekzekutimin e aktgjykimit, vëmendje e

68 Siç thekson gjykatësi Wojtyczek [Vojtuček]] në paragrafin 8 nga Mendimi i tij i veçuar për pajtimin e tij ndaj këtij aktgjykimi.

69 Paragrafi 8 nga Mendimi i veçuar.

70 Paragrafi 9 nga Mendimi i veçuar.

71 Council of Europe, Resolution CM/ResDH(2019)190, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights, Makraduli against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 4 September 2019 at the 1352nd meeting of the Ministers' Deputies), i qasshëm në: <https://bit.ly/3il2A5A>, nga dt. 14.10.2022.

72 1355th meeting (September 2019) (DH) - Action report (26/06/2019) - Communication from North Macedonia concerning the case of Makraduli v. North Macedonia (Application No. 64659/11), DH-DD(2019)719, i qasshëm në: <https://rm.coe.int/0900001680953cc0>, paragrafët 11 dhe 12, prej dt. 14.10.2022.

veçantë i kushtohet procesit të dekriminalizimit të ofendimit dhe shpifjes në përputhje me Rezolutën 1577 (2007) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.⁷³

Gjatë mbylljes së kësaj çështjeje, Komiteti i Ministrave përcakton se shteti, krahas pagesës së dëmshpërblimit të drejtë, i ka miratuar edhe të gjitha masat e tjera të nevojshme, duke përfshirë edhe masat e veçanta që duhet t'i japin fund shkeljeve të konstatuara dhe të fshijnë konsekuencat e tyre në mënyrë që të arrihet sa më shumë që të jetë e mundur kthimi në gjendje të mëparshme për aplikantin (*restitutio in integrum*), si dhe masat e përgjithshme që do të parandalojnë shfaqjen e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen.

2.3. GELEVSKI⁷⁴

Fakte mbi rastin

Në rastin e *Gelevskit*, aplikanti, i cili ishte kolumnist, u dënua penalisht për shpifje nga gjykatat vendase, si rezultat i një mendimi kritik të shprehur ndaj një gazetari tjetër për një çështje me interes publik, gjatë një debati “të nxehtë” publik. Aplikanti botoi një kolumnë të tij në të cilën ai bëri një përmbledhje kritike të disa ngjarjeve aktuale për publikun vendas, në të cilën ai njëkohësisht shprehte disa gjykime vlerësuese ndaj paditësit në procedurën e brendshme i cili, nga ana tjetër, ishte një gazetar dhe redaktor i njohur në publikun vendas.

Gjykata vendase e shkallës së parë e shpalli aplikantin fajtor për shpifje dhe ofendim ndaj paditësit dhe i shqiptoi atij gjobë në të holla në shumë prej 600 eurosh, si alternativë me tridhjetë ditë burg në rast të mospërbushjes së detyrimit dhe në të njëjtën kohë e urdhëroi aplikantin që të paguajë taksën gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore të paditësit në shume prej 150 euro. Gjykata vendase konstatoi se aplikanti ka paraqitur qëllimisht të pavërteta dhe pretendime të pabaza për paditësin në kolumnën e tij, duke dëmtuar kështu nderin dhe reputacionin e paditësit. Gjykata vendase i hodhi poshtë pretendimet e aplikantit se ai, në fakt, merrej me pikëpamjet politike të paditësit në kolumnën e tij, kështu që kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të kuptohet si një sulm ndaj reputacionit dhe dinjitetit të tij. Në këtë kontekst, sipas aplikantit, shkrimet e mëparshme dhe deklaratat publike të paditësit përmbanin gjuhë të urrejtjes dhe, për këtë arsye, kolumna e aplikantit kishte për qëllim mbrojtjen e njerëzve nga një “linçim” i tillë politik. Sipas aplikantit, me kolumnën e kontestuar, ai synonte të mbronte vlerat kushtetuese, si lirinë e tubimit dhe shoqërimin e lirë të studentëve.

Aplikanti ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë, duke argumentuar, ndër të tjera, se kolumnat e tij përmbanin opinionet e tij personale, të cilat ishin gjykime vlerësuese dhe jo deklarata mbi fakte. Gjykata e shkallës së dytë vendosi pjesërisht në favor të aplikantit. Në fakt, kjo gjykatë e konfirmoi dënimin e saj vetëm në lidhje me shpifjen e shprehur, për arsyen se konstatoi se aplikanti nuk mund të shpallet një-

73 Council of Europe, Parliamentary Assembly, Resolution 1577 (2007) Towards decriminalization of defamation, 4 October 2007.

74 *Gelevski v. North Macedonia*, no. 28032/12, 8 October 2020

kohësisht fajtor për dy bazat e të njëjtit nen, respektivisht edhe për shpifje edhe për ofendim në të njëjtën kohë. Në të njëjtën kohë, Gjykata e shkallës së dytë ia ka ulur sanksionin penal në shumë prej 320 euro, si alternativë me gjashtëmbëdhjetë ditë burgim në rast mospagese. Gjykata e hodhi poshtë argumentin e ankuesit se kolumna përmbante gjykime vlerësuese me arsyetimin se: “Që një deklaratë të konsiderohet gjykim vlerësues, ajo nuk duhet të lidhet me një ngjarje apo dukuri specifike dhe duhet të bëhet në mënyrë abstrakte. Në rastin konkret, teksti i publikuar i referohet një ngjarjeje konkrete... dhe përmban një pretendim faktik që i nënshtrohet vërtetimit, provës dhe përcaktimit. Barra e provës është mbi...të pandehurin”.⁷⁵

Aplikanti, brenda afatit kohor, ka parashtruar edhe një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese, si mjeti i fundit juridik efektiv në rendin juridik të brendshëm, me të cilën i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë se gjykatat e rregullta vendore, me vendimet e tyre me të cilat ai ka qenë i sanksionuar penalisht për gjykime të shprehura vlerësuese, i është shkelur e drejta e tij e garantuar me kushtetutë për lirinë e ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit.

Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë ankesën kushtetuese të aplikantit me qëndrimin se gjykatat e rregullta vendase me aktgjykimet e tyre kanë ndëshkuar opinionin e shprehur publikisht të aplikantit si masë e domosdoshme për të mbrojtur reputacionin, dinjitetin dhe nderin e një shtetasi tjetër, respektivisht që aplikanti, duke u mbështetur në lirinë e tij të shprehjes publike, ka shkelur të drejtën e mbrojtur të një qytetari tjetër. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se arsyet e dhëna nga gjykatat e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë ishin të pranueshme dhe se kufizimi i të drejtës së lirisë së shprehjes nga shteti, në rastin konkret, ishte në proporcion me qëllimin legjitim të mbrojtjes së reputacionit të viktimës (paditësit).

I pakënaqur me vendimet e brendshme, aplikanti parashtrroi ankesë (aplikim) në GJEDNJ. Ai në ankesën e tij ka theksuar se të vetmen deklaratë faktike që përmban artikulli ka të bëjë me kundër-demonstruesit që nga Gostivari kanë arritur në sheshin kryesor të Shkupit për të prishur protestën e studentëve. Pjesët e tjera të kolumnës ishin një artikulum i opinioneve dhe pikëpamjeve të tij personale, duke reflektuar pakënaqësi me politikën e partisë politike që ishte në pushtet në atë kohë. Sipas tij, qëllimi i kolumnës ishte nxitja e debatit publik për çështjet me interes publik: tubimet publike dhe liria e shprehjes në shtetin amë. Në ankesën e tij, aplikanti nuk e mohoi se kishte përdorur një mënyrë shprehjeje provokuese, por nëse ajo merrej në kontekstin e debatit të gjallë publik, që shpërtheu në atë kohë, nuk mund të konsiderohej një arsye e mjaftueshme për dënimin e tij. Ai mohoi që në kolumnën e tij kishte bërë thirrje për dhunë, përkundrazi kishte shprehur shqetësimin e tij për dhunën e ndodhur (që ishte tema e kolumnës), duke thënë se dhuna mund të çojë në një dhunë më të madhe.

Gjetje të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Gjykata, nga ana e saj, arriti në përfundimin se kufizimi në fjalë kishte për qëllim mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve dhe, siç u përcaktua nga gjykatat vendase, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës.

75 Paragrafi 10 i aktgjykimit.

Ajo që ishte vendimtare në këtë rast ishte të përcaktohej nëse kufizimi ishte “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”. Për këto arsye dhe për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, Gjykata i ka marrë parasysh elementet e mëposhtme përkatëse: pozicionin e aplikantit, pozicionin e paditësit, vetë objektin e publikimit, gjuhën e përdorur nga aplikanti dhe shumën e shqiptuar të dënimit.

Gjykata, fillimisht, vuri në dukje se aplikanti ishte një kolumnist i rregullt në gazetën e përditshme. Për këto arsye, mbrojtja që i takonte aplikantit ishte në nivelin e mbrojtjes gazetareske dhe mediatike, respektivisht në nivelin që ka shtypi i lirë në sigurimin e funksionimit të duhur të një shoqërie demokratike.⁷⁶

Më tej, Gjykata vuri në dukje se po aq është i rëndësishëm edhe roli (funksioni) i personit të prekur (paditësit në procedurën e brendshme). Shkalla në të cilën një individ ka një profil publik më të dukshëm, ose është më i njohur për publikun, ka një efekt të kundërt në mbrojtjen që mund t’i ofrohet në kontekstin e paraqitjeve të tij publike. Në rastin konkret, paditësi në proceset e brendshme ishte i njohur për publikun. Si gazetar dhe kryeredaktor i njohur i një kanali televiziv dhe i një gazete ditore, ai është ekspozuar me vetëdije para shqyrtimit të veprimeve dhe opinioneve të tij profesionale, si nga gazetarët ashtu edhe nga publiku i gjerë.⁷⁷

Për këto arsye, ai ishte i detyruar të tregonte një shkallë më të madhe tolerance ndaj qëndrimeve të shprehura ndaj tij.⁷⁸ Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse merren parasysh “detyrat dhe përgjegjësitë” që paditësi i ka pasur si gazetar dhe kryeredaktor i mediave, dhe veçanërisht parimi i gazetarisë së përgjegjshme dhe etikës gazetareske në raportim. Sipas Gjykatës, këto përfundime luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm në ditët e sotme, duke pasur parasysh ndikimin që kanë mediat në shoqërinë moderne, dhe ky është fakt se ato jo vetëm informojnë, por përmes mënyrës së njoftimit mund të ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e informacioneve: “Në një botë në të cilën individit përballet me një sasi të madhe informacionesh, të qarkulluara përmes mediave tradicionale dhe elektronike, me një numër në rritje pjesëmarrësish, monitorimi i harmonizimit me etikën gazetareske merr një rëndësi shtesë”.⁷⁹

Për sa i përket lëndës së publikimit, Gjykata vuri në dukje se kolumna nuk përmbante asnjë informacion në lidhje me jetën private të paditësit. Respektivisht, ajo pasqyronte mosmarrëveshjen e aplikantit me politikën e qeverisë dhe si e tillë, ajo kontribuoi në debatin e vazhdueshëm politik në atë kohë si një çështje me interes publik. Si pjesë e atij debati, kolumna e kontestuar përmbante gjykime vlerësuese kundër gazetarëve të ndryshëm, përfshirë edhe paditësin, të cilët në atë kohë ishin mbështetës publikë të politikave të qeverisë. Në atë kontekst, Gjykata përsëriti se kufijtë e gazetarisë kritike dhe investigative janë gjithashtu një çështje e interesit legjitim publik. Gjykatat e brendshme penale, nga ana e tyre, përcaktuan se artikulli i aplikantit përmban deklarata faktike, pa i vërtetuar faktet konkrete që pretendohet se janë paraqitur

76 *Falzon v. Malta*, no. 45791/13, § 57, 20 March 2018

77 Paragrafi 24 i aktgjykimit

78 *Medžlis Islamske Zajednice Brčko and Others v. Bosnia and Herzegovina* [GC], no. 17224/11, 27 June 2017

79 *Stoll v. Switzerland* [GC], no. 69698/01, § 104, ECHR 2007-V

nga aplikanti. Edhe nëse do të bëhej fjalë për deklarime faktike, Gjykata vërejti se besueshmëria e tyre nuk ishte kontestuar as nga paditësi dhe as nuk ishte shqyrtuar nga gjykatat penale. Praktikisht, gjykatat e brendshme u kufizuan vetëm në ndikimin abstrakt që kolumna pati tek paditësi. Nga ana tjetër, Gjykata vuri në dukje se Gjykata Kushtetuese i cilësoi pretendimet e aplikantit si gjykime vlerësuese.

Së katërti, për sa i përket gjuhës së përdorur nga aplikanti në kolumnë, Gjykata ka nënvizuar se individët, dhe në veçanti gazetarët që marrin pjesë në një debat publik për çështje me interes të përgjithshëm, gëzojnë liri më të madhe për t'u shërbyer me në një shkallë të caktuar ekzagjerimi ose provokimi në deklaratat publike⁸⁰. Duke marrë parasysh se paditësi ishte një gazetar i njohur, nga njëra anë, ndërsa çështjet e trajtuara në kolumnë ishin me interes të veçantë publik në atë kohë, nga ana tjetër, Gjykata pranoi se deklaratat e aplikantit në kolumnë nuk i kalonin kufijtë e pranueshëm të kritikës. Aq më tepër që as gjykatat e brendshme nuk gjetën asnjë element të gjuhës së urrejtjes apo nxitjes së dhunës në deklaratat e aplikantit.

Më në fund, Gjykata arriti në përfundimin se dënimi penal i aplikantit, pa dyshim, mund të kishte pasur një efekt frikësues në debatin politik midis anëtarëve të mediave për çështje të rëndësishme me interes publik.

Si konkluzion i aplikacionit të sipërpërmendur, Gjykata vendosi se kufizimi në fjalë i lirisë së shprehjes së aplikantit ishte në disproporcion me qëllimin, respektivisht nuk ishte "i domosdoshëm në një shoqëri demokratike", në kuptimin e nenit 10 paragrafi 2 të Konventës.

Koment

Parimet e ngulitura thellë në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut në kontekstin e mbrojtjes së gazetarëve dhe profesionistëve mediatik mund të zbatohen në mënyrë të barabartë edhe për individët që mund të quhen mbrojtës të të drejtave të njeriut (ose organizatat e tyre joqeveritare - aktivitetet e të cilave kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave), por edhe studiuesve akademikë, kolumnistëve apo autorëve të literaturës që synojnë të trajtojnë çështje me interes publik. Të gjithë këta individë gëzojnë një nivel të lartë mbrojtjeje për lirinë e shprehjes, sepse roli i tyre në mbikëqyrjen publike është "i ngjashëm me atë të shtypit". Ata, sipas Gjykatës, mund të quhen edhe "mbrojtës publikë", të cilët duhet të gëzojnë mbrojtjen e parashikuar nga neni 10 i Konventës në të njëjtin nivel me mediat tradicionale.

Nga ana tjetër, Gjykata gjithmonë i kushton vëmendje të konsiderueshme seriozitetit që mund të ketë një sanksion penal në rastet e shpifjes dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për një temë të caktuar me interes publik. Në lidhje me këtë, Gjykata, në disa raste, ka përsëritur se shqiptimi i dënimit me burg në raste të tilla mund të jetë në përputhje me lirinë e shprehjes, të garantuar nga neni 10 i Konventës, vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, respektivisht vetëm kur shkelen seriozisht disa të drejta tjera, si për shembull: në

80 *Do Carmo de Portugal e Castro Câmara v. Portugal*, no. 53139/11, § 43, 4 October 2016

rastet e gjuhës së urrejtjes ose nxitjes së dhunës. Në këtë drejtim, Gjykata shpesh bën thirrje për zbatimin e vazhdueshëm të Rezolutës 1577 (2007) të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, e cila u kërkon të gjitha shteteve-anëtare, ligjet e të cilëve ende parashikojnë dënime me burg për shpifje/ofendim, t'i shfuqizojnë ato, madje edhe kur ato parashikohen vetëm si dënime alternative.

Ekzekutimi i aktgjykimit

Komiteti i Ministrave e mbylli ekzekutimin e rastit Gelevski pasi konstatoi se masat e përgjithshme të ndërmarra në kontekstin e *Makradulit*, të cilat para së gjithash i referohen dekriminalizimit të shpifjes, janë po aq të rëndësishme edhe në lidhje me këtë rast konkret.

Përveç kësaj, Komiteti i Ministrave shprehu kënaqësinë për masat e veçanta që u zbatuan nga shteti, në drejtim të pagesës së dëmshpërblimit të drejtë dhe ndalimit të pasojave negative që do të pësonte aplikanti në të ardhmen, duke pasur parasysh se me miratimin e LPCOSH-së është ndërprerë plotësisht zbatimi i sanksionit penal të shqiptuar ndaj tij.⁸¹

2.4. KOSTOVA DHE APOSTOLOV⁸²

Fakte mbi rastin

GJEDNJ-ja, me aktgjykimin e shqiptuar të saj në rastin *Kostova dhe Apostolov*, konstatoi shkelje të nenit 10 në lidhje me procedurën civile të shpifjes që u zhvillua kundër aplikantëve, kryeredaktoret dhe redaktoret përgjegjëse të së përvajshmes "Fokus", Jadranka Kostova dhe Vlado Apostolov - gazetar në këtë javore. Kjo procedurë ka nisur në lidhje me dy shkrime të botuara në këtë javore më 3 dhe 4 janar 2013, të cilat i referoheshin z. S, i cili në atë kohë ishte anëtar i lartë i partisë politike në pushtet dhe drejtor i DSK-së.⁸³

Në ato shkrime gazetareske, aplikantët e kanë cituar z. I., ish-ambasador i Republikës së Maqedonisë në Çeki, i cili, ndër të tjera, u ka thënë se z. S. e ka shpërdoruar autoritetin e tij duke ndërmarrë veprime dhe duke ushtruar presion të konsiderueshëm verbal ndaj Presidentit të atëhershëm Maqedonisë (Gj.I.) dhe ministrit të Punëve të Jashtme (N.P.), gjë që është reflektuar në mënyrë dëmtuese ndaj interesave të z. I në çështjen personale që kishte të bënte me kinse rrëmbimin e fëmijës së tij të mitur nga ish-bashkëshortja.

81 Për më shumë detale në lidhje me ekzekutimin e këtij aktgjykimi, shih rezolutën finale: Council of Europe, Resolution CM/ResDH(2021)160, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights, Gelevski against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 16 September 2021 at the 1411th meeting of the Ministers' Deputies), i qasshëm në: <https://bit.ly/3GX3z68>, si dhe Raportin e veprimit 1411th meeting (September 2021) (DH) - Action report (06/07/2021) - Communication from North Macedonia concerning the case of Gelevski v. North Macedonia (Application No. 28032/12) (Group Makraduli v. North Macedonia (Application no. 64659/11), DH-DD(2021)697, i qasshëm në <https://bit.ly/3GXq8aL>, prej dt. 19.10.2022.

82 *Kostova and Apostolov v. North Macedonia*, no. 38549/16, 5 April 2022

83 Titulli i artikullit të parë ka qenë me titull „U largova për shkak të presionit nga Sasho Mijalkov“, ndërsa teksti i dytë pa pasur titullin „Ambasada e Çekisë nën kërcënimin e bombave, MPJ nuk lëviz fare“, Shih a1 on: *Mijalkovi kërkon 27.000 euro nga "Fokus" për dëmtimin e nderit dhe reputacionit*, Shkup, 11.01.2013, <https://a1on.mk/macedonia/mijalkov-od-fokus-bara-27-000-evra-za-nar/>, пристапено на 08.10.2022

Në fjalinë e fundit të shkrimit të dytë thuhej se z. S. “jozyrtarisht” zotëronte “perandori biznesi në Republikën Çeke”. Para publikimit të këtyre shkrimeve, aplikanti i dytë u përpoq pa sukses të merrte një përgjigje nga z. S., kështu që e ka kontaktuar zëdhënësin e DSK-së.⁸⁴

Sikurse Gjykata Themelore Shkup 2⁸⁵ ashtu edhe Gjykata e Apelit Shkup⁸⁶ kanë konstatuar se aplikantët e kanë njollosur reputacionin e z. S., duke publikuar fakte të rreme, të cilat i kanë cilësuar si “thashetheme”, pa u përpjekur paraprakisht të verifikonin besueshmërinë e tyre. Gjykatat kanë vlerësuar se informacionet e publikuara nuk i kanë shërbyer ndonjë interesi publik dhe se jeta private e z. I. lidhej në mënyrë të pajustificueshme me postin publik që e ka mbajtur z. S.. Aplikanti i parë është urdhëruar të paguajë 5000 euro dhe aplikanti i dytë është urdhëruar të paguajë 1000 euro si dëmshpërblim për dëmin jomaterial të shkaktuar ndaj z. S., ndërsa z. I. është urdhëruar t’i paguajë 10.570 euro z. S. si dëmshpërblim për dëmin e reputacionit të tij. Këto pretendime u konfirmuan më pas nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka vendosur pas kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të parashtruar nga aplikantët.⁸⁷

Gjetje të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Në fillim të analizës së saj, Gjykata pranon se i vetmi “qëllim legjitim” që kanë synuar gjykatat vendase ngjatë ndërhyrjes në lirinë e shprehjes së aplikantëve ishte mbrojtja e të drejtave dhe reputacionit të z. S.⁸⁸

Mbase në artikujt fillimisht janë trajtuar probleme që ndërlidhen me jetën personale të z. I., ato njëkohësisht kanë prekur çështje me interes publik, respektivisht çështje që kanë të bëjnë me kinse ushtrimin e padrejtë të presionit verbal nga z. S. në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë ndaj funksionarëve të lartë të shtetit, siç është Presidenti dhe Ministri i Punëve të Jashtme. Prandaj, Gjykata ka vlerësuar se informacioni për kinse shpërdorim të detyrës nga një funksionar i lartë i shtetit në lidhje me çështje të natyrës personale të z. I. ka mundur të kontribuojë në debatin publik.⁸⁹

Më tej, GJEDNJ-ja është pajtuar me qëndrimin e gjykatave vendase se tekstet e kontestuara kanë përmbajtur deklarata faktike që i nënshtroheshin provës. Edhe pse të gjitha ato, në thelb, kanë çuar në “histori” ose “thashetheme”, siç kanë konstatuar edhe gjykatat vendase, gjykatat nuk e kanë marrë parasysh faktin se ato nuk e kishin origjinën nga aplikantët. Në fakt, ata vetëm kanë raportuar për atë që z. I. ua ka rrëfyer dhe ua ka dhënë deklaratën e tij me shkrim për ngjarjet bazuar në përvojën e tij. Në tekstet, aplikantët i kanë shënuar qartë deklaratat që vinin nga z. I. (duke e cituar atë ose duke përdorur fjalim indirekt).

84 Paragrafët 2-3 të aktgjykimit.

85 Aktgjykimi 8P4-30/13a i Gjykatës Themelore Shkup II, i dt. 27.12.2013.

86 Aktgjykimi GZH-1742/14 i Gjykatës së Apelit, i dt. 03.09.2014.

87 Paragrafi 4 i aktgjykimit të GJEDNJ. Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, U.nr. 164/2014 i dt. 14 tetor 2015, i qasshëm në: <http://ustavensud.mk/?p=11421>, prej dt. 10.10.2022.

88 Paragrafi 7 i aktgjykimit.

89 Paragrafi 8 i aktgjykimit.

Përveç kësaj, në procedurën e kësaj lënde, nuk është vërtetuar se përmbajtja e publikuar në tërësi ishte e pasaktë apo se ishte e sajuar. Në masën që kishte një interes legjitim për të mbrojtur z. S. nga deklaratat e supozuara shpifëse të z. I., ai interes, sipas GJEDNJ-së, mbrohej në masë të madhe nga mundësia që kishte z. S. sipas legjislacionit vendas, të fillojë procedurë për shpifje ndaj z. I. - madje duke e ndërmarrë atë veprim. Krahas kësaj, deklarata në lidhje me “perandorinë e biznesit në Çeki” të z. S., e cila është përmendur në fjalinë e fundit të tekstit të dytë, ishte shënuar në atë mënyrë që tregohet qartë se informacioni ishte marrë nga një burim anonim. Prandaj, GJEDNJ-ja vëren se ajo deklaratë nuk ka pasur mundësi t’i vë lexuesit në hamendje lidhje me të vërtetën e asaj që u tha nga z. I., por ka synuar të hidhte dritë mbi lidhjet afariste të z. S. me Republikën Çeke. GJEDNJ-ja thekson më tej se aplikanti i dytë u përpoq ta konfirmonte historinë përmes zëdhënësit zyrtar të Drejtorisë. Për më tepër, qeveria nuk ka vënë në dukje asnjë aspekt të z. S. për të treguar se nderi dhe reputacioni i tij ishin dëmtuar rëndë.⁹⁰

Në përcaktimin e shkeljes së nenit 10 të KEDNJ-së në këtë çështje, në masë të madhe ka kontribuar edhe devijimi nga parimi i proporcionalitetit në lidhje me dëmshpërblimet e shqiptuara. Më konkretisht, GJEDNJ-ja vëren se dëmshpërblimi i shqiptuar për aplikantin e parë arrinte në pesëmbëdhjetë paga minimale mujore në momentin e ngjarjeve në shtet, ndërsa në lidhje me aplikantin e dytë arrinte në tre paga minimale mujore. Në të njëjtën kohë, GJEDNJ-ja konstaton se ato shuma kishin një efekt frenues, gjë që të “dekurajojë diskutimin e hapur për tema me interes publik”, pavarësisht faktit se vetë aplikantët nuk i kanë paguar ato.⁹¹ Në fakt, këto dëmshpërblime, si dhe shpenzimet në procedurë janë mbuluar nga fondi i solidaritetit të SHGM-së.⁹² Prandaj, konkluzioni i GJEDNJ-së ishte logjik se shumata e shqiptuara të dëmshpërblimeve për dëmin e shkaktuar jomaterial gjykatat nuk kanë ofruar raport të arsyeshëm proporcionaliteti në lidhje me shkeljen e reputacionit të pretenduar që ka pësuar z. S.⁹³

Duke vepruar në bazë të kërkesave të tyre për kompensim të drejtë, të theksuar në përputhje me nenin 41 të Konventës, dhe në lidhje me shkeljen e pësuar të nenit 10, GJEDNJ-ja u ndau të dy aplikantëve së bashku një kompensim prej 3,000 euro për dëmin jomaterial, plus 1,250 euro për shpenzimet e shkaktuara në procedurën para tij.⁹⁴

Koment

Aktgjykimi i *Kostova dhe Apostolov* është veçanërisht i rëndësishëm për gazetarët, sepse me të GJEDNJ-ja riafirmon standardet që janë relevante për ushtrimin e lirisë së gazetarisë për të informuar publikun për çështje me interes më të gjerë publik. Në këtë kuptim, përveç disproporcionalitetit të dëmshpërblimit të shqiptuar ndaj gazetarëve, të cilët paraqiten si aplikantë në këtë rast, shkeljes së konstatuar të lirisë së tyre të shprehjes, në një masë të madhe ishte edhe për faktin se ata ishin shqiptuar, ndonëse GJEDNJ-ja ka konstatuar në mënyrë të pakontestuar se “aplikantët kanë vepruar me kujdesin e duhur, që pritet nga

90 Paragrafi 9 i aktgjykimit.

91 Paragrafi 10 i aktgjykimit të GJEDNJ.

92 Paragrafi 4 i aktgjykimit të GJEDNJ.

93 Paragrafi 10 i aktgjykimit të GJEDNJ.

94 Paragrafët 12-13 të aktgjykimit të GJEDNJ.

gazetarët përgjegjës që raportojnë për një çështje me interes publik, dhe ata nuk është dashur të kritikoheshin se kanë dështuar të konstatojnë të vërtetën e pretendimeve të kontestueshm.⁹⁵

Vendimet e gjykatave vendase që u shqyrtuan më vonë nga GJEDNJ-ja,⁹⁶ si dhe vetë aktgjykimi i miratuar në Strasburg,⁹⁷ shkaktojnë vëmendje të madhe në qarqet gazetareske dhe në mesin e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile që i kushtohen problematikë së lirisë së shprehjes, si në në vend dhe më gjerë.

Aktgjykimi i shpallur nga GJEDNJ-ja mbështet pretendimet e paraqitura nga SHGM-ja që nga viti 2014 se vendimi i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Shkupit ka cenuar rëndë lirinë e shprehjes dhe ka frenuar gazetarët të shkruajnë për keqpërdorime të mundshme të pushtetit, ndërsa kompensimet e shqiptuara për dëmet jomateriale ishin shumë të larta dhe jo-proporcionale me standardin e gazetarëve të vendit. Në këtë kuptim, SHGM-ja atëherë apeloj se me to gjykata po vendos një praktikë të papranueshme që gazetarët të dënohen për shpifje për shkak të një deklarate të transmetuar, sepse nëse gazetarët i verifikojnë faktet e çdo deklarate, siç kërkohet nga Gjykata, atëherë shumica e deklaratave të figurave publike nuk do të duhej të publikoheshin.⁹⁸ Aq më tepër, SHGM-ja ka shprehur shqetësimin edhe lidhur me praktikën gjyqësore që krijohet pas dekriminalizimit të shpifjes në vend dhe efektit të pafavorshëm të vendimeve gjyqësore në imazhin ndërkombëtar të vendit.⁹⁹

Për më tepër, sanksionet e shqiptuara janë cilësuar si drakoniane.¹⁰⁰ Kështu, për shembull, sipas Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik shqiptimi i “dënimeve të larta për gazetarët, të shtuara me shpenzime gjyqësore jashtëzakonisht të larta, kur një bartës i postit publik paraqitet si paditës, e ilustron tendencën në Maqedoni për të ngulfatur lirinë e shprehjes dhe mosrespektimin praktikës fundamentale demokratike, e cila mbështetet në maksimumin se gazetaria ka për detyrë dhe obligim të kontrollojë dhe të kritikojë punën e pushtetit. Rezultati i padisë ... është një tjetër konfirmim se problemi me lirinë e shprehjes dhe ushtrimin e gazetarisë profesionale dhe kritike nuk është çështje dekriminalizimi apo ndonjë materie tjetër ligjore, por një çështje e mungesës së kapaciteteve elementare demokratike tek bartësit e pushtetit ekzekutiv, por edhe atij gjyqësor”.¹⁰¹

95 Paragrafi 11 i aktgjykimit. Në këtë kuptim, GJEDNJ e citon edhe aktgjykimin e Björk Eiðsdóttir v. Iceland, no. 46443/09, § 81, 10 July 2012.

96 International Freedom of Expression Exchange (IFEX), *Macedonian investigative magazine “Fokus” fined thousands of euros in defamation case*, 2014, <https://ifex.org/macedonian-investigative-magazine-fokus-fined-thousands-of-euros-in-defamation-case/#.VEDHKRT-3YA.twitter> ; Popovska, T., *Macedonian Court Fines Journalist and Magazine for Quoting Source*, 2014, <http://globalvoicesonline.org/2014/02/23/macedonian-court-fines-journalist-and-magazine-for-quoting-source/>; Radisic, D., *Macedonian Appellate Court Confirms Defamation Verdict for Independent Magazine*, 2014, <https://globalvoices.org/2014/10/07/macedonian-appellate-court-confirms-defamation-verdict-for-independent-magazine/>, të gjitha prej dt. 06.10.2022.

97 Advox Global Voices, *European Court of Human Rights vindicates Macedonian journalists convicted of defamation*, 2022, <https://advox.globalvoices.org/2022/04/07/european-court-of-human-rights-vindicates-macedonian-journalists-convicted-of-defamation/>, të gjitha prej dt. 06.10.2022.

98 TTelma, *Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg ka vendosur në favor të “Fokus” në rastin kundër Sasho Mijalkov*, 2022, <https://telma.com.mk/2022/04/05/европскиот-суд-за-човекови-права-во-ст/>, prej dt. 06.10.2022.

99 MKD, DHGM: *Mihajkov të heq dorë nga të hollat e aktgjykimit kundër Fokus*, 2014, <https://www.mkd.mk/makedonija/znm-mijalkov-da-se-otkaze-parite-od-presudata-protiv-fokus>, prej dt. 06.10.2022.

100 Marusic J.S., *Critical Macedonian Weekly Faces ‘Draconian’ Fine*, 2014, <https://balkaninsight.com/2014/01/20/critical-macedonian-weekly-faces-draconian-sentence/>; Civil Today, *Journalists under fire again: Draconic fines for Fokus*, 2014, <https://civil.today/journalists-under-fire-again-draconic-fines-for-focus/>, prej dt. 06.10.2022.

101 Stankoviq, S., *9.000 euro dëmshpërblim për shefin e DSK dhe për avokatin e tij*, 2014, <https://mk.voanews.com/a/fokus-mijalkov-case/1832587.html>, prej dt. 06.10.2022.

Në aktgjykimin mbi rastin në fjalë të GJEDNJ-së janë të pranishëm disa elemente relevante për realizimin e mëtejshëm efektiv dhe të papenguar të lirisë së shprehjes dhe kryerjes profesionale të detyrave gazetareske në vend.

Në fakt, fillimisht, me të identifikohet ekzistenca e **interesit publik** për të diskutuar hapur çështje që lidhen drejtpërdrejt me mënyrën e ushtrimit të pushtetit dhe kryerjes së funksioneve shtetërore nga bartësit e tyre, duke përfshirë edhe abuzimet e mundshme të manifestuara përmes ushtrimit të funksionit publik për qëllime private. Fatkeqësisht, duket se interesi publik ka mbetur i panjohur në vendimet e gjykatave vendase dhe se mangësia gjatë ndarjes së drejtësisë nga ana e tyre, ndonëse nuk përmendej shprehimisht në vendimin e GJEDNJ-së, nënkuptohet në arsyetimin e tij.

Për më tepër, ky aktgjykim e thekson rëndësinë e konceptit të **“detyrave dhe përgjegjësiwe”**, i cili është inherent në ushtrimin e lirisë së shprehjes nga gazetarët. Ky nënkupton se mbrojtja e shtuar që i ofrohet shtypit sipas nenit 10 të Konventës “është subjekt i kushtit që mediat të veprojnë në përputhje me detyrimin e tyre konsekuent për **gazetari të përgjegjshme**. Koncepti i “gazetarisë së përgjegjshme” mund të përkufizohet si respektim i plotë i rregullave të “etikës” gazetareske dhe “kodeve profesionale” në kryerjen e veprimtarisë profesionale nga gazetarët. Është po aq e rëndësishme si për gazetarët, ashtu edhe për redaktorët në media.

Në fakt, detyra e shpërndarjes së informacioneve përfshin detyrimisht detyra dhe përgjegjësi, si dhe kufizime që shtypi duhet t’i vendosë në mënyrë spontane vetes.¹⁰² Garancitë mbrojtëse që neni 10 u siguron gazetarëve në lidhje me raportimin për çështje me interes publik i nënshtrohen kushtit që ata të veprojnë në mirëbesim dhe mbi një bazë të saktë faktike, si dhe që të sigurojnë informacione “të besueshme dhe të sakta” në përputhje me etikën e gazetarisë.¹⁰³

Mirëbesimi në ushtrimin e profesionit gazetaresk mund të përcaktohet duke iu referuar fakteve dhe rrethanave në çdo rast individual, si dhe duke inkorporuar respektimin e etikës gazetareske, veçanërisht duke marrë parasysh ndikimin që e kanë mediat në shoqërinë moderne, në një botë në të cilën individi përballet me sasi të mëdha informacionesh.¹⁰⁴

Përmes analizës së shkurtër të fakteve në kuadër të këtij rasti gjyqësor, GJEDNJ-ja konstaton se aplikantët kanë vepruar drejt dhe në përputhje me standardet e gazetarisë së përgjegjshme.

Përfundimisht, mungesa e **proporcionalitetit në sanksionet e shqiptuara** ndaj gazetarëve dhe “efekti parandalues i mundshëm” që mund të kishte shkaktuar kjo është aspekti i fundit dhe kyç që është theksuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e përcakton rezultatin përfundimtar në vendimarrjen e saj, në drejtim të konstatimit të shkeljes së nenit 10 të Konventës.

102 *Mater v. Turkey*, no. 54997/08, § 55, 16 July 2013.

103 *Axel Springer AG v. Germany* [GC], § 93; *Bladet Tromsø and Stensaas v. Norway* [GC], § 65; *Pedersen and Baadsgaard v. Denmark* [GC], § 78; *Fressoz and Roire v. France* [GC], § 54; *Stoll v. Switzerland* [GC], § 103; *Kasabova v. Bulgaria*, §§ 61 and 63-68; *Sellami v. France*, §§ 52-54; *Bergens Tidende and Others v. Norway*, § 53; *Goodwin v. the United Kingdom*, § 39; *Fressoz and Roire v. France* [GC], § 54.

104 *Stoll v. Switzerland* [GC], no. 69698/01, § 104, ECHR 2007-V.

Ekzekutimi i aktgjykimit

Shteti i ka dorëzuar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës një raport veprimi, në të cilin i ka nënvizuar masat e veçanta dhe të përgjithshme të ndërmarra për ekzekutimin e këtij vendimi, krahas pagesës në kohë të dëmshpërblimit të drejtë të dhënë nga GJEDNJ-ja.¹⁰⁵

Më konkretisht, si masë më vete, u konstatua përsëritja e procedurës gjyqësore për rastin në fjalë për shpifje pas aktgjykimit të KEDNJ-së në bazë të nenit 400 të Ligjit për procedurë kontestimore – të cilën mundësi aplikantët nuk e kanë shfrytëzuar.¹⁰⁶

Masat e përgjithshme, nga ana tjetër, që shteti i ka renditur përfshijnë aktivitetet e zakonshme për përkthimin, publikimin dhe shpërndarjen e aktgjykimit në institucionet relevante dhe edukimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kurse në rastin konkret shteti ka paralajmëruar edhe miratimin e Ligjit të ri për Procedurë Civile për Ofendim dhe Shpifje. Ky ligj, ndër të tjera, do të reduktonte kufijtë e sipërm të kompensimit për dëmin jomaterial që shqiptohet në rastet gjyqësore kur konstatohet se gazetarët, redaktorët ose mediat si persona juridikë janë përgjegjës për ofendim ose shpifje.¹⁰⁷

Lë përshtypje fakti që shteti mbështetet në të dhënat e paraqitura nga SHGM-ja, në analizën e saj të vitit 2021¹⁰⁸, që tregojnë një reduktim drastik të numrit të padive për ofendim dhe shpifje kundër gazetarëve, për të arritur në përfundimin se praktika gjyqësore vendase ka përmbushur kërkesat që rezultojnë nga Konventa.¹⁰⁹

Procesi i ekzekutimit të këtij aktgjykimi është në vijim e sipër dhe nuk është përmbyllur zyrtarisht para Komitetit të Ministrave.

105 1451st meeting (December 2022) (DH) - Action Report (27/09/2022) - Communication from North Macedonia concerning the case of Kostova and Apostolov v. North Macedonia (Application No. 38549/16), DH-DD(2022)1032, i qasshëm në: <https://bit.ly/3uaeK3Z>, paragrafët 11 dhe 12, prej dt. 14.10.2022

106 Paragrafi 4 i Raportit të veprimit.

107 Paragrafët 8-13 nga Raporti i veprimit.

108 C Spirovski, M., Nasteska Kalanoska, B. (2022), Tregues për shkallën e lirisë së shprehjes të mediave dhe për sigurinë e gazetarëve në vitin 2021, Shkup, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, i qasshëm në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/05/MK-MK-2021-finalen-izvestaj.pdf>, prej dt. 15.10.2022.

109 Paragrafi 10 i Raportit të Veprimit.

3. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Rigjallërimi efektiv i lirisë së shprehjes, në përgjithësi, dhe i mandatit të gazetarisë, më konkretisht, është i mundur vetëm duke krijuar një mjedis legjislativ dhe institucional, për zbatimin aktual të standardeve të Strasburgut në kontekstin mediatik dhe gjyqësor të Maqedonisë.

Duket se distanca kohore që ka kaluar që nga miratimi i katër aktgjyqimeve të GJEDNJ-së sipas nenit 10 është ende e pamjaftueshme për të bërë një vlerësim të saktë lidhur me ndikimin e mundshëm pozitiv që ato kanë pasur në zhvillimin e mëtejshëm të praktikës gjyqësore vendase dhe në krijimin e kushteve për funksionimin e qetë të mediave të lira në shoqërinë e vendit tonë.

Megjithatë, edhe para miratimit të disa prej këtyre aktgjyqimeve, e sidomos pas miratimit të tyre, vërehet një trend pozitiv që duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen, për të parandaluar shkeljet e ardhshme të nenit 10 të KEDNJ-së. Ky trend manifestohet, si përmes zvogëlimit të numrit të padive për përgjegjësi civile për shpifje dhe ofendim, ashtu edhe përmes rritjes së monitorimit dhe zbatimit të standardeve të GJEDNJ-së nga gjykatat vendase që, pjesërisht, është rezultat i aktiviteteve intensive edukative të zbatuara me mbështetjen e disa organizatave ndërkombëtareve, duke përfshirë edhe Këshillin e Evropës. Të gjithë së bashku kontribuuan në faktin se për momentin nuk ka asnjë rast të dorëzuar (komunikuar) për t'u prononcuar nga Regjistri i KEDNJ-së në Byronë për Përfaqësimin e Shtetit para GJEDNJ-së, i cili përmban pretendime ankimore sipas nenit 10 të KEDNJ-së.

Për të mundësuar më tej lirinë e shprehjes, veçanërisht për gazetarët dhe punonjësit e tjerë mediatik, në përputhje me kërkesat e Strasburgut, rekomandohet si më poshtë:

- Gjykatat e vendit tonë duhet të vazhdojnë të ndjekin dhe zbatojnë në mënyrë konsekuente jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila i referohet lirisë së shprehjes, duke inkorporuar parimet dhe standardet përkatëse në arsyetimin e vendimeve në rastet në të cilat veprojnë, si dhe duke iu referuar dhe cituar mendimet e GJEDNJ-së në aktgjykimet referuese konkrete, me fokus të veçantë në rastet gjyqësore të vendit tonë, në masën që ato janë relevante.
- Vëmendje e veçantë kur trajtohen çështjet që lidhen me përgjegjësinë civile për shpifje dhe ofendim duhet t'i kushtohet kuptimit dhe trajtimit të drejtë dhe adresimit të konceptit të debatit në interes të publikut, si dhe përcaktimit të saktë të statusit të palëve si politikanë, figura publike figurave apo gazetarëve, subjektit të deklaratave të kontestuara, si dhe cilësimit të tyre si pohime faktike apo gjykime vlerësuese sipas dallimit të bërë nga GJEDNJ-ja.
- Gjykatat duhet të kenë parasysh, veçanërisht kur bëhet fjalë për shprehjen gazetareske në kontekstin e çështjeve që shkaktojnë interes publik, se vëllimi i lirisë së shtypit duhet të ndërtohet në mënyrën më të gjerë të mundshme, në mënyrë që të lejojë një shkallë të caktuar ekzagjerimi, madje edhe provokimi. Gazetarët gëzojnë lirinë për të zgjedhur në mënyrë të pavarur, nga informacionet që u vijnë, me cilin prej tyre dhe në çfarë mënyre do të merren.
- Gjykatat duhet të jenë veçanërisht të kujdesshme kur bëjnë analizën proporcionale dhe balancimin ndërmjet të drejtës për të mbrojtur reputacionin e dikujt, nga njëra anë, dhe lirisë së shprehjes politike në drejtim të hapjes së një diskutimi për çështje të rëndësishme politike ose shoqërore, nga ana tjetër, sidomos kur si paditës paraqiten politikanë apo bartës të funksioneve publike, kurse të paditurit janë gazetarë.
- Autoritetet vendase duhet të kenë gjithmonë parasysh se shtypi gëzon hapësirën më të gjerë të mundshme të mbrojtjes së lirisë së shprehjes. Një mbrojtje e tillë mbulon edhe aktivitetet përgatitore të gazetarëve për një njoftim, hulumtimin që ata bëjnë, si dhe konfidencialitetin e burimeve gazetareske. Natyrisht, kjo nënkupton edhe të drejtën e gazetarëve për të qenë të pranishëm në vendin e ngjarjeve, sepse çdo ndalim apo kufizim sjell efekte të drejtpërdrejta negative që i pengojnë gazetarët të marrin informacione të dorës së parë dhe të vëzhgojnë drejtpërdrejt ngjarjet, bazuar në praninë e tyre personale, kurse elementet e tilla janë domethënëse në realizimin e profesionit të tyre gazetaresk dhe publiku nuk duhet të privohet prej tyre.

- Gjykatat duhet të vazhdojnë praktikën pozitive të shqiptimit të kompensimeve të vogla apo edhe simbolike për reputacionin e dëmtuar ose, nëse është e mundur, të shqyrtojnë mundësinë të përmbahen nga caktimi i ndonjë kompensimi. Në fakt, në vend të kësaj, ato duhet, sa herë që e konsiderojnë të mundshme, të përcaktojnë se vërtetimi i përgjegjësive civile për shpifje ose ofendim përbën satisfaksion të mjaftueshëm material për paditësin, veçanërisht në procedimet kundër gazetarëve. Kjo do të ishte në përputhje me kërkesën e GJEDNJ-së për proporcionalitet të sanksioneve të shqiptuara, dhe pa iu qasur miratimit të një LPCOSH të ri, që do të parashikonte zgjidhje të reja në lidhje me kufijtë e sipërm të shumave që shqiptohen si kompensim për dëmin jomaterial.
- Gjykatat duhet gjithashtu të zbatojnë drejt konceptin e “detyrave dhe përgjegjësive”, i cili është i një rëndësie vendimtare në çështjet/rastet e ndjeshme, të cilat mund të rezultojnë në ndërhyrje të mundshme, në ushtrimin e lirisë së shprehjes nga gazetarët dhe redaktorët në media. Në fakt, mbrojtja e parashikuar nga neni 10 për gazetarët në lidhje me informacionet për çështje të interesit të përgjithshëm i nënshtrohet kushtit që gazetarët të veprojnë me vullnet të mirë dhe mbi bazën e saktë faktike, respektivisht të sigurojnë informacione “të besueshme dhe të sakta” në përputhje me etikën e gazetarisë.
- Autoritetet vendase duhet të kenë gjithmonë parasysh se shtypi gëzon hapësirën më të gjerë të mundshme të mbrojtjes së lirisë së shprehjes. Një mbrojtje e tillë mbulon edhe aktivitetet përgatitore të gazetarëve për një njoftim, hulumtimin që ata bëjnë, si dhe konfidencialitetin e burimeve gazetareske. Natyrisht, kjo nënkupton edhe të drejtën e gazetarëve për të qenë të pranishëm në vendin e ngjarjeve, sepse çdo ndalim apo kufizim sjell efekte të drejtpërdrejta negative që i pengojnë gazetarët të marrin informacione të dorës së parë dhe të vëzhgojnë drejtpërdrejt ngjarjet, bazuar në praninë e tyre personale, kurse elementet e tilla janë domethënëse në realizimin e profesionit të tyre gazetaresk dhe publiku nuk duhet të privohet prej tyre.
- Studiuesit akademikë, kolumnistët apo autorët e literaturës, që synojnë trajtimin e çështjeve me interes publik, duhet të kenë të njëjtin nivel mbrojtjeje në kontekst të të drejtave të garantuara nga neni 10 i Konventës, si gazetarët e tjerë apo profesionistët mediatik. Kjo vlen njëllë edhe për blogerët dhe për përdoruesit e njohur të mediave sociale, roli i të cilëve gjithashtu mund të barazohet me atë të “mbrojtësve publikë”, në kontekstin e mbrojtjes që ofron neni 10 i Konventës.
- Shqiptimi i dënimeve me burgim në rastet e garantuara nga neni 10 i Konventës mund të jenë në përputhje me lirinë e shprehjes vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, respektivisht vetëm kur cenohen rëndë të drejtat e tjera themelore si, për shembull, kur bëhet fjalë për gjuhën e urrejtjes ose nxitjen e dhunës.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve, të marra së bashku në tërësinë e tyre, do të mundësojnë përmbushjen e plotë të misionit të mediave në shekullin e 21-të për të luajtur një rol thelbësor si “mbrojtës” në shoqëritë demokratike. Kjo do të thotë se, në praktikë, ato do të jenë në gjendje të kryejnë detyrën e tyre për të transmetuar informacione dhe ide për të gjitha çështjet me interes publik pa pengesë - që është komplementare me të drejtën e publikut për të marrë informacione dhe ide të tilla.¹¹⁰

110 *Satakunnan Markkinapörssi Oy and Satamedia Oy v. Finland* [GC], § 126; *Bédat v. Switzerland* [GC], § 51; *Axel Springer AG v. Germany* [GC], § 79; *The Sunday Times v. the United Kingdom* (no. 2), § 50; *Bladet Tromsø and Stensaas v. Norway* [GC], §§ 59 and 62; *Pedersen and Baadsgaard v. Denmark* [GC], § 71; *News Verlags GmbH & Co.KG v. Austria*, § 56; *Dupuis and Others v. France*, § 35; *Campos Dâmaso v. Portugal*, § 31.



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

www.znm.org.mk